

06 Zanafilla e inceneratorëve: Emergjencja mjedisore u shpall pa bazë ligjore

Dëshmi dhe dokumente tregojnë se shpallja e emergjencës mjedisore kombëtare në fillim të vitit 2014 – e cila i hapi rrugë kontratave për inceneratorët e Elbasanit dhe Fierit, u bazua në një vendim të kontestuar, që “nuk kishte fuqi ligjore dhe vendimmarrëse”.

12 ‘Krimet’ me koncesionet parashkruhen, ndërsa SPAK dremit mbi dosje

Vonesat e Prokurorisë së Posaçme me hetimin e koncesionit të sterilizimit të pajisjeve kirurgjikale kanë sjellë parashkrimin e një prej veprave penale të dyshuara, duke shmangur përgjegjësit e dyshuar nga ndëshkimi ligjor.

14 Gjuetia e paligjshme: Në liqenin e Fierzës nuk bie më ‘peshk në grep’

Peshkatarët e licesuar në liqenin e Fierzës kthehen shpesh me rrjeta të zbrazëta për shkak të rënies së sasisë së peshkut në liqen, që sipas ekspertëve vjen për shkak të peshkimit të paligjshëm dhe mungesës së menaxhimit të liqenit.

Reporter.al

Nr. 79
Mars 2022
E përmuajshme

BYRN
BALKAN
INVESTIGATIVE
REPORTING
NETWORK | ALBANIA

PLAZHI NË DHËRMI U PËRFITUA NGA ‘KUNATA’ E MINISTRES XHAÇKA

‘INVESTIMI STRATEGJIK’/Këshilli i Ministrave i dha në përdorim për një periudhë 30-vjeçare një plazh në Dhërmi, partneres amerikane të vëllait të ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka, duke ngritur shqetësime për nepotizëm dhe konflikt interesi.



Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka. Foto: LSA

PLAZHI NË DHËRMI U PËRFITUA NGA 'KUNATA' E MINISTRES XHAÇKA	04
ZANAFILLA E INCENERATORËVE: EMERGJENCA MJEDISORE U SHPALL PA BAZË LIGJORE	06
ÇMIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE NË SHQIPËRI FRYHET NGA HUMBJET DHE KONCESIONET	10
'KRIMET' ME KONCESIONET PARASHKRUHEN, NDËRSA SPAK DREMIT MBI DOSJE	12
GJUETIA E PALIGJSHME: NË LIQENIN E FIERZËS NUK BIE MË 'PESHK NË GREP'	14
AKTORI QË IMITON RAMËN BËHET FYTYRA E PROTESTAVE NË SHQIPËRI	15

ENGLISH EDITION

ALBANIAN MINISTER'S HUSBAND WINS LUCRATIVE 'RIVIERA' BEACH LEASE	18
COURT RULING STRENGTHENS BERISHA'S GRIP ON ALBANIA'S DEMOCRATIC PARTY	19
DOUBLE ACT: RAMA'S TV IMPERSONATOR BECOMES FACE OF PROTESTS ROCKING ALBANIA	20
BALKANS BRACE FOR ECONOMIC BLOWBACK OF WAR IN UKRAINE	22
'FALSE HOPE': BURUNDIANS DUPED INTO PAYING BIG FOR SERBIA ASYLUM	26
BALLET DANCERS FLEEING UKRAINE FIND NEW STAGE IN ROMANIA	30



4-5
Këshilli i Ministrave i dha në përdorim për një periudhë 30-vjeçare një plazh në Dhërmi, partneres amerikane të vëllait të ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka, duke ngritur shqetësime për nepotizëm dhe konflikt interesi.



6-7
Dëshmi dhe dokumente tregojnë se shpallja e emergjencës mjedisore kombëtare në fillim të vitit 2014 - e cila i hapi rrugë kontratave për inceneratorët e Elbasanit dhe Fierit, u bazua në një vendim të kontestuar, që "nuk kishte fuqi ligjore dhe vendimmarrëse".



10-11
Ka disa faktorë që përcaktojnë çmimin e energjisë elektrike që qytetarët dhe bizneset detyrohen të paguajnë në vende të ndryshme. Ky është një shpjegim i shkurtër për faktorët e kostove në Shqipëri.



15
Peshkatarët e licesuar në liqenin e Fierzës kthehen shpesh me rrjeta të zbrazëta për shkak të rënies së sasisë së peshkut në liqen, që sipas ekspertëve vjen për shkak të peshkimit të paligjshëm dhe mungesës së menaxhimit të liqenit.

Reporter.al

Është publikimi i Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Investigative në Shqipëri - BIRN Albania. BIRN Albania është një organizatë jo-fitimprurëse, e cila mbështet zhvillimin e gazetarisë investigative në Shqipëri me qëllim ekspozimin e rasteve të korrupsionit dhe promovimin e të drejtave të njeriut në vend. Ky publikim i përmuajshëm është një përmbledhje e disa prej artikujve të botuar nga rrjeti BIRN në faqen www.reporter.al dhe www.balkaninsight.com. Ky publikim shpërndahet falas. Printimi dhe shpërndarja e tij mundësohet nga:

Qeveria Suedeze

National Endowment for Democracy

STAFI

Kristina Voko, drejtoresh e BIRN Albania
Besar Likmeta, Kryeredaktor
Aleksandra Bogdani, redaktore
Gjergj Erebara, redaktor
Vladimir Karaj, redaktor
Edmond Hoxhaj, gazetar

KONTAKTONI:

Rruga Nikolla Jorga,
Kulla 8, Ap. 8, Tiranë
E-mail: office.albania@birn.eu.com
Tel: +35544502592
URL: <http://www.reporter.al/>

Ngjarjet e Marsit



PROTESTA KUNDËR RRRITJES SË ÇMIMEVE

Mijëra qytetarë marshuan për disa ditë radhazi në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" në Tiranë në shenjë proteste për rritjen e çmimeve të karburantit dhe të produkteve të tjera të shportës.

Foto: Nensi Bogdani/ BIRN

Basha dorëhiqet si kryetar i PD

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha shpalli dorëheqjen e tij nga drejtimi i opozitës pas humbjeve të njëpasnjëshme elektorale dhe presionit në rritje nga ish-kryetari Sali Berisha. Basha e shpalli dorëheqjen në një fjalim të mbajtur para grupit parlamentar demokrat. "...për të ndihmuar Partinë Demokratike dhe demokratët të lënë mënjane ndasitë joparimore, i vetëdijshëm për peshën që mora mbi vete, për atë që e kam quajtur vendimin tim më të vështirë politik, kam vendosur të hedh një hap pas duke u dorëhequr nga detyra e kryetarit të PD," deklaroi Basha. Ai deklaroi se do të mbetet mbështetës i partisë dhe se do të punojë "për ringritjen e saj". Lulzim Basha hyri në skenën politike shqiptare në vitin 2005 si një fytyrë e re për Partinë Demokratike, pjesë e një platforme politike të krijuar nga Sali Berisha të quajtur "Komiteti për Orientimin e Politikave". Në shtator 2021, Basha vendosi të përjashtojë ish-kryetarin Berisha nga grupi parlamentar për shkak të shpalljes së këtij të fundit nga Shtetet e Bashkuara si person i përfshirë në korrupsion madhor.

Gjykata njeh kongresin e Berishës

Konflikti politik në Partinë Demokratike mes dy grupeve kundërshtarë është futur në një ngërç ligjor, pas një vendimi të marrë të premtën nga gjykata e shkallës së parë për njohjen e vendimeve të Kuvendit të 11 dhjetorit. Ky Kuvend u thirr jashtë strukturave zyrtare të partisë nga grupimi i ish-kryeministrit Sali Berisha, i cili inicioi një betejë kundër pasardhësit të tij Lulzim Basha. Basha e përjashtoi nga partia pasi Berisha u shpall "non grata" nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Gjykata njoftoi se ka pranuar kërkesën e palës kërkuese Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit të kësaj partie dhe depozitoi vendimet e Kuvendit Kombëtar të datës 11 dhjetor duke rregjistruar ndryshimet përkatëse në regjistrin e partive politike vendimet e marra nga ky Kuvend. Vendimi i gjykatës u kontestua nga Enkelejd

Alibeaj, kryetar i komanduar i kësaj partie pas dorëheqjes së Lulzim Bashës disa ditë më parë. Ai e cilësoi vendimin e pazbatueshëm dhe paralajmëroi ankimim në apel. Ndërkohë Alibeaj sulmoi gjyqtarin Agron Zhukri duke akuzuar për shpërdorim detyre dhe tha se do të ketë kallëzim penal ndaj tij.

Ndarja e "tortës" në Këshillin e RTSH

Përfaqësues të shumicës dhe pakicës parlamentare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, pranuan haptazi politizimin e Radio Televizionit Shqiptar, duke kërkuar përfaqësim politik në Këshillin Drejtues të këtij institucioni publik. Opozita këmbënguli që dy anëtarët e rinj që do të zgjidhen në këtë këshill t'i takojnë asaj, pasi nuk i është dhënë mundësia e përfaqësimit për shkak të mungesës në Kuvend gjatë legjislaturës së shkuar. Edhe pse ligji ia njeht drejtën e propozimit të kandidatave shoqatave të medias, universiteteve dhe organizatave të shoqërisë civile, mënyra e përzgjedhjes i ka lënë në dorë politikës të bëjë pazaret e saj. Deputeti socialist Petro Koçi, si drejtues i mbledhjes, njoftoi se bëhej fjalë për dy vende vakante që sipas tij, i takonin njëri shumicës dhe tjetri pakicës parlamentare. Por deputeti i Partisë Demokratike, Luçiano Boçi kërkoi që të dy vendet t'i lihen opozitës, si balancim pasi sipas tij 8 anëtarët aktualë në këshill i kishte zgjedhur mazhoranca. Vakancat në këtë këshill janë kthyer gjithmonë në përplasje politike, edhe pse ligji i kërkon televizionit publik që të jetë i paanshëm politikisht në punën e tij.

Strukturë e re për të zhdukurit në komunizëm

Në një përpjekje të re për të avancuar me kërkimin dhe identifikimin e personave të zhdukur gjatë regjimit komunist në Shqipëri, Kuvendi miratoi të enjten kërkesën e Autoritetit të Dosjeve, AIDSSH, për ngritjen e një strukturë të posaçme që do të merret me këtë çështje. Struktura quhet Drejtoria për Marrëdhëniet

Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur do të ketë një organikë me 5 punonjës, një drejtor dhe 4 specialistë, me fushë veprimi bashkëpunimin ndërinstitucional për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe marrjen e masave për ruajtjen e vendvarrimeve. Kryetarja e Autoritetit të Dosjeve, Gentiana Sula i tha BIRN se ngritja e strukturës ishte një domosdoshmëri për realizimin e detyrave ligjore të AIDSSH-së. "Këto detyra të reja të ngarkuara janë sa të rëndësishme, po aq voluminoze dhe kërkojnë jo vetëm ekspertizë specifike në këtë fushë, por edhe punë të dedikuar në terren, atje ku parashikohet të jenë të lokalizuara vendvarrimet," tha Sula.

Në mbrojtje të shkabës së rrezikuar

Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA), theksoi rëndësinë e ngritjes së një rrjeti të formuar nga komunitetet lokale në Shqipëri, që po i shërbejnë kauzës mjedisore të mbrojtjes dhe rimëkëmbjes së popullatës së Kalit të Qyqes. "Rrjeti 'Shpëtimtarët e Kalit të Qyqes' (SEVN), i përbërë prej 40 profesionistëve të ndryshëm si fermerë, veterinerë, barinj e blegtorë, ka ndërmarrë hapa konkretë në lidhje me konservimin dhe mbrojtjen e kësaj specie", citojnë aktivistët mjedisorë në deklaratën për shtyp. Kontributi i tyre konsiston në ngritjen e dy Stacioneve Ushqimore Suplementare në Nivicë dhe Glinë, stacione që ofrojnë ushqim të kontrolluar dhe pa helm, specifikisht rreth 40 kg ushqim në muaj për njërin çift të shkabave, si edhe 20-30 kg në javë për çiftin tjetër. Kali i Qyqes është një ndër katër llojet e fundit të shkabave të viseve malore që shumohen në Shqipëri, dhe mbartnin statusin e "rrezikuar". Përgjatë viteve, në mbrojtje të specisë së Kalit të Qyqes janë ndërmarrë aktivitete të tilla si monitorime në terren, ndërtimi i stacioneve suplementare, aksione parandaluese ndaj rreziqeve që has kjo shkabë, shpërndarja e kiteve kundër helmimit, dhe së fundmi krijimi i këtij rrjeti komunitar.

INVESTIGIM

Investimi strategjik: Plazhi në Dhërmi u përfitua nga 'kunata' e ministres Xhaçka

Këshilli i Ministrave i dha në përdorim për një periudhë 30-vjeçare një plazh në Dhërmi, partneres amerikane të vëllait të Ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka duke ngritur shqetësime për nepotizëm dhe konflikt interesi.

BLERINA GJOKA | BIRN | TIRANË

Më 2 mars, Këshilli i Ministrave shpalli vendimin për dhënien në përdorim të një zone bregdetare në Dhërmi për një periudhë 30-vjeçare në favor të kompanisë 'AGTCC Hotel Management', pasi kjo e fundit mori statusin e investitorit strategjik nga Komiteti i Investimeve Strategjike, i cili udhëhiqet nga kryeministri Edi Rama.

Sipas të dhënave të publikuara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, kompania 'AGTCC Hotel Management' është në pronësi të Tawni Lin Grzych-Sutton, një 31-vjeçare e lindur në Masaçusets të Shteteve të Bashkuara dhe banore e rezidencës "Kodra e Diellit" në Tiranë.

Sutton është gjithashtu partnerja prej shumë vitesh e Andi Xhaçkës - vëllai i ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka, një fakt që për ekspertët ngre shqetësime për konflikte të mundshme interesi dhe nepotizëm.

Rasti në fjalë është sipas Zef Preçit, drejtues i Qendrës për Kërkime Ekonomike, tregues se ligji i investimeve strategjike është kthyer në instrument për personat e lidhur me pushtetin.

"Madje qoftë edhe një konflikt në dukje i interesit formon detyrimin për deklaram për subjektin përkatës vendimarrës, gjë që nuk dihet nëse është bërë apo jo," tha Preçi për BIRN.

Kompania e Sutton e fitoi të drejtën e përdorimit të tokës në bregdet nëpërmjet një marrëveshjeje me kompaninë AG.TCC Sh.p.k - në pronësi 100% të Artan Gaçit, ish-deputet socialist dhe njëkohësisht bashkëshort i ministres Xhaçka.

Kompania e Gaçit ka marrë statusin 'investitor strategjik' për ndërtimin e një hoteli me pesë yje dhe me kapacitet prej 106 suitash në Dhërmi, të quajtur "Dreamades Luxury Suites", ndërsa vendimi i Këshillit të Ministrave i hap rrugën e përdorimit afatgjatë të brigjeve të detit dhe plazhit përballë hotelit të tij.

Gaçi i tha BIRN më 3 mars se për të shmangur konfliktin e interesit, 'kishte gjetur një kompani amerikane me përvojë për të menaxhuar investimin dhe plazhin',

por të dhënat e siguruar nga BIRN tregojnë se kërkimet e tij janë kufizuar brenda familjes. Ministria e Punëve të Jashtme, Olta Xhaçka, bashkëshorti i saj, Artan Gaçi dhe drejtori i Agjencisë për Media dhe Informim pranë Këshillit të Ministrave, Endri Fuga nuk iu përgjigjën kërkesave për koment. BIRN u përpoq gjithashtu të kontaktonte me Tawni Sutton dhe Andi Xhaçkën, por asnjëri prej tyre nuk qe i arritshëm për koment.

Investimi strategjik

Ligji për investimet strategjike, i miratuar në vitin 2015 dhe i shtyrë dy herë nga Parlamenti i njeh statusin 'investitor strategjik' në turizëm çdo projekti që investon më shumë se 5 milionë euro dhe punëson 80 punëtorë.

Projekti "Dreamades Luxury Suites" i kompanisë AG. TCC të Artan Gaçit e ka përfituar statusin e investitorit strategjik më 29 mars 2021, sipas vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike, KIS që BIRN e disponon.

Kompania 'AGTCC Hotel Management' në pronësi të Sutton është regjistruar në QKB me 25 qershor 2021. Veprimet e regjistrimit janë bërë me prokurorë nga juristja Iris Erebara, e cila është gjithashtu juriste e kompanisë 'AG.TTC' Sh.p.k në pronësi të Artan Gaçit.

Pas regjistrimit në QKB, dy kompanitë kanë nënshkruar një marrëveshje për operimin e strukturave turistike në projektin "Dreamades Luxury Suites", ku përfshihet dhe operimi i stacioneve të plazhit përballë hotelit. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, 'AG.TTC' Sh.p.k i ka kërkuar Komitetit të Investimeve Strategjike reflektimin e saj në vendimin e shpalljes së investimit strategjik.

Më 15 korrik 2021, Komiteti i Investimeve Strategjike i kryesuar nga kryeministri Edi Rama e miratoi kërkesën dhe i njohu kompanisë së sapokrijuar nga Sutton masën mbështetëse të lejimit të përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonën përkatëse të plazhit përballë kompleksit për një afat 30-vjeçar.

Në dy vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike përcaktohen edhe lehtësi të tjera për dy kompanitë në pronësi të familjarëve të afërt të ministres Xhaçka, të tilla si asistencë dhe procedurë e përshpejtuar për çdo akt administrativ, funksionimin e shërbimeve mbështetëse të furnizimit me ujë, lidhjen në rrjetin elektrik, kanalizimet e ujërave dhe infrastrukturë rrugore për objektin.

Neni 70, pika 3 e Kushtetutës i ndalon deputetët që të kryejnë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri



Foto e Andi Xhaçkës dhe Tawni Sutton e postuar nga Heather Sutton


të tyre. Për shkelje të paragrafit 3, çështja mund të dërgohet në Gjykatë Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.

Drejtori i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, Sokol Nano nuk i dha një përgjigje të drejtpërdrejtë pyetjes së BIRN nëse përfitimi i tokës publike nga të afërmit e ministres Xhaçka përbënte shqetësim për konflikt interesi.

"I gjithë procesi është legal. AIDA ka bërë verifikimin e të gjithë dokumenteve për dhënien e statusit," tha Nano.

Nga studente në investitore

Ligji për investimet strategjike ka për qëllim thithjen e kapitalit të huaj ose 'zgjimin' e kapital vendas, për të përthithur investime në sektorë të rëndësishëm ekonomikë, duke krijuar vende të reja pune dhe zhvillim rajonal, nëpërmjet ofrimit të teknologjive të reja për rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të investimit, duke siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit. Ky ligj është shfrytëzuar kryesisht nga qeveria e kryeministrit Edi Rama



Skema e lidhjes së kompanive me investimin strategjik Dreamades Luxury Suites



Resorti në Drymades, Artan Gaçi: 'Unë jam investitori strategjik'

Qeveria shqiptare i ka dhënë statusin e investitorit strategjik për ndërtimin e një hoteli dhe shfrytëzimin e një zonë bregdetare në Himarë, një kompanie në pronësi të bashkëshortit të ministres së Jashtme, Olta Xhaçka dhe ish-deputetit socialist, Artan Gaçi.

BLERINA GJOKA | BIRN | TIRANË

Në mbledhjen e së mërkurës, Këshilli i Ministrave shpalli një vendim për dhënien në përdorim të një zone bregdetare në Himarë për resortin "Dreamades Luxury Suites" për një periudhë 30-vjeçare.

Sipas këtij vendimi, kompanisë 'AGTTC Hotel Management' i jepet leje e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, që po ndërtohet në fshatin Gjilekë të bashkisë Himarë.

Në vendimin e qeverisë, 'AGTTC Hotel Management' sh.p.k, cilësohet si investitor strategjik. Në Qendrën Kombëtare të Biznesit, QKB, kjo kompani figuron në pronësi të shtetases amerikane, Tawni Lin Grzych-Sutton.

"Bashkia Himarë ka detyrimin që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik "AGTTC Hotel Management" sh.p.k, me NUIS M11825022K, të lidhë kontratën përkatëse për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në përputhje me sipërfaqet e destinacionin e kërkuar nga

subjekti, të lejuara me vendimin nr.3/5, datë 29.3.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike, të ndryshuar, dhe të konfirmuara më tej nga Bashkia Himarë," shkruhet në vendim.

Megjithatë, të dhënat e siguruar nga BIRN tregojnë se kjo kompani është themeluar tre muaj pas vendimit për shpalljen e investitorit strategjik, që ndryshe nga sa sugjeron vendimi i Këshillit të Ministrave, është kompania me emër të ngjashëm, AG.TTC Sh.p.k - në pronësi 100% të ish-deputetit socialist dhe bashkëshortit të ministres së Punëve të Jashtme, Olta Xhaçka.

"Unë jam investitor strategjik dhe po ndërtoj një hotel, nuk po ndërtoj vila siç bëjnë të tjerët," tha Gaçi për BIRN dhe shtoi se sipas ligjit, "më takon zona e plazhit përballë hotelit për të vënë shezlongët".

Shpallja si investitor strategjik nga Këshilli i Ministrave i bashkëshortit të Ministres së Punëve të Jashtme ngre shqetësime për konflikt interesi. Gaçi i tha BIRN se për këtë arsye ai kishte futur në mes kompaninë 'AGTTC Hotel Management'.

"Por, pikërisht për të shmangur këtë konflikt interesi, unë gjeta një kompani tjetër me përvojë në këtë fushë, e cila do të marrë në menaxhim hotelin dhe plazhin dhe unë jam thjesht investitori," shpjegoi Gaçi. "Kam folur me shumë

juristë për këtë," shtoi ai, ndërsa pranoi se kompaninë e Tawni Lin Grzych-Sutton e 'ka përzgjedhur ai.'

Sipas Gaçit, mes kompanisë së tij dhe "AGTTC Hotel Management" është bërë një kontratë, ku njëra do të bëjë investimin dhe tjetra menaxhimin.

BIRN kërkoi koment nga Këshilli i Ministrave përmes drejtorit të Agjencisë për Media dhe Informim, Endri Fuga, nëse ky vendim ishte në konflikt interesi, por nuk mori një përgjigje deri në botimin e këtij shkrimi.

Kompania 'AGTTC Hotel Management' është regjistruar në QKB me 25 qershor 2021. Veprimet e regjistrimit janë bërë me prokurorë nga juristja Iris Erebara, e cila është gjithashtu juriste e kompanisë 'AG. TTC' Sh.p.k në pronësi të Artan Gaçit.

Gaçi këmbënguli se nuk kishte pse të penalizohej për të bërë biznes pse është bashkëshorti i ministres Olta Xhaçka, ndërsa theksoi se nuk e shihte si problem që kompanitë kishin të njëjtën juriste.

"Nuk ka lidhje, juristja ime Iris Erebara e ka asistuar kompaninë amerikane që të bëjë regjistrimin në QKB," tha ai. "Nuk ka asnjë abuzim këtu, thjesht po vuaj pasojat që jam burri i ministres."

në fushën e turizmit, për të konsoliduar pronat e kontestuara për korrupsion dhe falsifikime, mbi të cilat janë ngritur resorte me vila në bregdetin e Jonit.

Ish-deputeti socialist Artan Gaçi njihet si investitor në fushën e ndërtimit dhe gastronomisë në Tiranë. Të dhënat e siguruar nga BIRN nuk tregojnë angazhime të mëparshme biznesi të Tawni Sutton, me përjashtim të ndjekjes prej saj të studimeve për Biznes në Universitetin e New Yorkut në Tiranë.

Edhe pse llogaritë e Sutton dhe Andi Xhaçkës në rrjetet sociale rezultojnë të mbyllura ose të fshira, gjurmë të marrëdhënies së tyre disa vjeçare - e cila duket se ka filluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vazhdojnë të ekzistojnë në internet në postimet e njerëzve të afërt.

Në vitin 2019, në faqen në internet të kompanisë amerikane të veshjeve dhe orendive shtëpiake 'Antropologie', ekziston një postim në emër të Tawni Sutton, e regjistruar për të marrë dhurata për 'festën e nuses së zonjës së ardhshme Xhaçka'.

Nëna e saj, Heather Sutton ka postuar gjithashtu në Instagram një foto me Andi Xhaçkën, ku pasi i uron ditëlindjen, shkruan se ishte "krenare që e kishte dhëndër". Në faqen e saj në Facebook, Heather Sutton mban gjithashtu foto të çiftit të vendosura në kornizë në shtëpinë e saj si dhe foto me të bijën dhe Xhaçkën pranë një peme krishtlindjesh.

BIRN siguroi gjithashtu dy numra telefoni nga një person që e njihnte Znj. Sutton, por rezultoi se njëri prej tyre është i regjistruar në emrin e Andi Xhaçkës dhe është lënë si kontakt i biznesit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit, QKB.

Persona që e njihnin çiftin i konfirmuan për BIRN në kushtet e anonimatit se çifti jetonte bashkë prej shumë vitesh, fillimisht në Shtetet e Bashkuara dhe më pas në Tiranë.



Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka. Foto: LSA

INVESTIGIM

Zanafilla e inceneratorëve: Emergjencia mjedisore u shpall pa bazë ligjore

Dëshmi dhe dokumente të siguruar nga BIRN tregojnë se shpallja e emergjencës mjedisore kombëtare në fillim të vitit 2014 – e cila i hapi rrugë kontratave për inceneratorët e Elbasanit dhe Fierit, u bazua në një vendim të kontestuar, që “nuk kishte fuqi ligjore dhe vendimmarrëse”.

BLERINA GJOKA | BIRN | TIRANË

Në fillim të shkurtit 2014, pesë zëvendësministra të qeverisë së udhëhequr nga kryeministri Edi Rama u mbledhën në një sallë mbledhjesh të Ministrisë së Mjedisit në rrugën e Durrësit në Tiranë, në funksionin e tyre si anëtarë të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Mbledhja e thirrur pa axhendë paraprake u tensionua pas një propozimi të ish-zv. ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Gjon Radovani për shpalljen e emergjencës mjedisore në territorin e Shqipërisë.

Propozimi u kundërshtua nga dy anëtarë të komitetit – Ylli Manjani dhe Arben Isaraj, duke e transformuar mbledhjen në dukje rutinë, në një diskutim maratonë mbi ligjshmërinë e vendimit për shpalljen e gjendjes së emergjencës mjedisore kombëtare.

Komiteti nuk arriti në konsensus, por sipas dy prej anëtarëve të Komitetit, Këshilli i Ministrave e qarkulloi dokumentin si një vendim qarkullues, duke marrë firmën e 3 prej 5 anëtarëve të komitetit.

Sipas kryeministrit Edi Rama, ky dokument është gurthemeli i procedurave që çuan në lidhjen e kontratave të partneritetit publik privat për inceneratorin e Elbasanit dhe të Fierit.

“Mbi këtë bazë, hap pas hapi kanë ndodhur të tjerat,” i tha Rama komisionit hetimor parlamentar të ngritur për të hetuar procedurat administrative që çuan në dhënien e kontratave të inceneratorëve.

Por dëshmitë e mbledhura nga BIRN nga anëtarët e Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve sugjerojnë se vendimi që kryeministri e konsideroi si pikënisjen e procedurave është në kundërshtim me ligjin, çfarë ngre pikëpyetje mbi gjithë hapat administrativë që pasuan deri në nënshkrimin e kontratave koncesionare.

I pyetur nga BIRN nëpërmjet drejtorit të Agjencisë për Median dhe Informacionin, Endri Fuga, Këshilli i Ministrave nuk komentoi mbi ligjshmërinë e vendimit për shpalljen e emergjencës mjedisore kombëtare deri në publikimin e këtij shkrimi.

Një vendim ekstraligjor

Prej vitësh, kontratat koncesionare për ndërtimin e inceneratorëve të Elbasanit, Fierit dhe Tiranës, të cilat llogaritet të kapin një vlerë më të madhe se 430 milionë euro,



I parashikuar për të përfunduar dy vite më parë, inceneratori i Fierit nuk ka filluar ende nga puna. Foto: Nensi Bogdani.

kanë qenë në qendër të akuzave për shpërdorim detyre nga zyrtarë të lartë dhe ministria.

Deri në muajin shkurt, buxheti i shtetit ka paguar 91.5 milionë euro – pa llogaritur TVSH-në për këto kontrata, nga të cilat 55 milionë euro kanë shkuar për inceneratorin e Elbasanit dhe atë të Fierit.

Në fund të tetorit, Kuvendi ngriti një komision hetimor për inceneratorët, ndërkohë që me 14 dhjetor, Prokuroria Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, arrestoi ish-ministrin e Mjedisit, Lefter Koka, i cili akuzohet për shpërdorim detyre dhe korrupsion në lidhje me procedurën e dhënies me koncesion të inceneratorit të Elbasanit. Koka i ka mohuar akuzat.

Gjatë seancës ku u thirr si dëshmitar në komisionin hetimor parlamentar, kryeministri Edi Rama theksoi se vendimi i datës 5 shkurt 2014, i marrë nga Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, kishte shërbyer si bazë ligjore ku është mbështetur

Këshilli Bashkiak i Elbasanit për shpalljen e emergjencës mjedisore dhe dhënien e kontratës ‘me negocim, pa shpallje paraprake’ kompanisë Albtek Energy. “Pra e nisëm për gjithë vendin, emergjencë kombëtare,” tha Rama gjatë dëshmisë së tij, duke iu përgjigjur pyetjes së deputetit Luçiano Boçi se mbi ç’bazë ligjore ishte bazuar emergjenca e shpallur nga bashkia Elbasan.

Një kopje e vendimit të datës 5 shkurt 2014 e siguruar nga BIRN, tregon se dokumenti është firmosur nga tre zëvendësministër anëtarë të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve – Oljana Ifti, Gjon Radovani dhe Dritan Hila. Ndërsa dy anëtarët e tjerë me profesion juristë – Ylli Manjani dhe Arben Isaraj nuk e kanë nënshkruar vendimin.

Tetë vjet më vonë, ata argumentojnë se kjo strukturë nuk kishte tagër ligjor për të marrë vendime.

Manjani i tha BIRN se kujtonte që gjatë mbledhjes në vitin 2014 e kishte kundërshtuar



Mbetjet e Fierit depozitohen në një landfill pranë godinës së inceneratorit. Foto: Nensi Bogdani.

L.SAPHOTO.COM



tuar axhendën e saj për arsye juridike dhe e cilësoi vendimin për shpalljen e emergjencës ‘nul’ nga kjo pikëpamje.

“Në këtë takim nuk kujtohem të kishim ndonjë axhendë paraprake, por aty në mbledhje na u prezantua nga zv/ministria e Mjedisit se jemi përpara një gjendje të rëndë mjedisore dhe se për këtë duhet shpallur një emergjencë mjedisore,” tha Manjani, i cili në atë kohë mbante funksionin e zv/ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.

Sipas tij, komitetet ndërministrorë janë mekanizma konsultativë politikash, ku zakonisht shkojnë si delegim zëvendësministra dhe në këto komitete nuk merren vendime që të kenë fuqi detyruese.

“Formalisht ky vetëm emrin ka komitet ministror, sepse në përbërje ka vetëm zv/ministria, të cilët nuk kanë fuqi kushtetuese, vendimmarrëse. Komiteti ndërministror në vetevete nuk merr vendime, aq më tepër të deklarojë gjendje emergjence, që sipas Kushtetutës i deklaroi qeveria,” tha ai.

Ish-zv/ministri i Drejtësisë, Arben Isaraj i tha gjithashtu BIRN se Komiteti nuk kishte tagër ligjor për të marrë vendime. Ai theksoi se detyra ligjore e këtij Komiteti ishte që në fund të çdo viti të dërgonte në Këshillin e Ministrave një raport për gjendjen mjedisore dhe hapat e ndërmarrë nga institucionet për përmirësimin e saj.

“Ne nuk kishim të drejtë të vendosnim,” tha Isaraj. “Komitetet nuk marrin vendime,” saktësoi ai, duke cituar disa herë ligjin “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.

Ligji “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” nuk parashikon që Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të shpallë gjendjen e emergjencës mjedisore. Vetë vendimi i 5 shkurtit 2014, bazohet në një vendim të Këshillit të Ministrave të datës 25 tetor 2013, i cili ia shtoi funksion Komitetit, duke e ngarkuar me përgjegjësinë për “shpalljen e fillimit dhe përfundimit të emergjencës mjedisore në vend”.



Kryeministri Edi Rama duke dëshmuar në komisionin hetimor parlamentar për 'inceneratorët'. Foto:LSA

Raporti i pakicës 'për inceneratorët' mbeti peng i konfliktit në PD

Një pjesë e deputetëve të opozitës i bashkuan votat me mazhorancën në rrëzimin e raportit përfundimtar të lexuar nga Tabaku – duke reflektuar ndasitë brenda kampit opozitar edhe në çështjen e koncesioneve të inceneratorëve.

BLERINA GJOKA | BIRN | TIRANË

Pas hetimit 4-mujor në Kuvend, raporti i Partisë Demokratike për tre kontratat koncesionare të inceneratorëve u braktis në momentin e votimit nga një pjesë e konsiderueshme e deputetëve opozitarë.

Raporti përfundimtar i pakicës mori 84 vota kundër dhe 27 vota pro, kundrejt raportit të mazhorancës që mori 76 vota pro dhe 34 vota kundër.

Në votimin përfundimtar të zbardhur nga Kuvendi vihet re se pesë deputetë demokratë – mbështetës të ish-kryeministrit Sali Berisha dhe tre deputetë të Lëvizjes Socialiste për Integrim votuan kundër raportit të pakicës. Mes votave kundër ishte edhe anëtarë i komisionit hetimor parlamentar, Belind Këlliçi. Ish-kryeministri Berisha nuk mori pjesë në votim.

Ndërkohë, 28 deputetë të tjerë opozitarë nuk morën pjesë në votim, përfshi edhe anëtarët e komisionit, Ina Zhupa dhe Edmond Spaho.

Hetimi parlamentar i aferës së inceneratorëve ekspozoi një seri shkeljesh ligjore dhe abuzimesh me kontratat koncesionare që llogaritet t'u kushtojnë shqiptarëve rreth 430 milionë euro si dhe dominoi axhendën politike me dëshmitë e zyrtarëve më të lartë të shtetit.

Megjithatë, punimet e këtij komisioni dhe veçanërisht votimi i së enjtes reflektuan gjithashtu përçarjen ekzistuese në kampin e opozitës.

E pyetur nga BIRN për votat kundër të deputetëve demokratë, kryetarja e komisionit, Jorida Tabaku e quajti këtë 'një gabim në gjykim'.

"Nuk e besoj dot që pas një pune të përbashkët në komision dhe një pune 6-vjeçare të Partisë Demokratike për të zbardhur këtë aferë korruptive, të kishte deputetë të opozitës që votojnë kundër," tha Tabaku.

Ndryshe nga Tabaku, Belind Këlliçi – një nga deputetët më aktivë në komisionin hetimor për inceneratorët, i tha BIRN se nuk kishte pasur mundësinë të

njihej me raportin e hartuar nga Tabaku.

"Raporti final i opozitës nuk më ishte vënë në dispozicion, u njoha me të vetëm në seancë dhe nuk pata kohën e mjaftueshme," tha Këlliçi.

Tabaku i hodhi poshtë pretendimet se nuk e kishte ndarë me kolegët raportin përfundimtar, ndërsa shtoi se raporti ishte publikuar në faqen online të Kuvendit që të hënën.

Komisioni hetimor parlamentar doli me dy raporte të kundërta pas një hetimi 4-mujor, ku opozita në 120 faqet e saj që iu bashkangjiten raportit të mazhorancës si "mendim i pakicës" pretendon se ka faktuar të gjitha akuzat e saj fill-estare për "grup të strukturuar kriminal", "skemë korruptive" dhe "pastrim parash" për të paktën 50 zyrtarë shtetërorë dhe përfaqësuesit e kompanive që kanë përfituar këto kontrata.

Ndërsa deputetët socialistë i mbrojtën kontratat koncesionare dhe theksuan rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit.

Raporti i mazhorancës doli vetëm në një konkluzion që kishte të bënte me mënyrën e funksionimit të hetimit parlamentar dhe sugjeron ndryshimin e ligjit për komisionet hetimore.

"Ligji nuk garanton mosshkeljen e parimit të rëndësishëm kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe ky është cedimi më i rëndë e që natyrisht nuk duhet lejuar më të ndodhë nga ligjvënës, të cilit i propozojmë rishikimin tërësor të ligjit," thuhet në raport.

Ministra, ish-ministra dhe deputetë të socialistë thanë se këto ishin projekte në shërbim të mjedisit dhe kishin ndryshuar situatën e menaxhimit të mbetjeve në vend, ndërkohë që një ish-ministër gjendet në burg i akuzuar për korrupsion dhe shpërndorim detyre në dhënien e këtyre kontratave.

Socialistët i qëndruan argumentit se "përgjegjësia është individuale" për kolegun e tyre Lefter Koka, ndërsa mbrojtën procedurat e ndjekura nga qeveria si në përputhje me ligjin dhe në shërbim të përmirësimit të situatës mjedisore në vend.

Sipas Isarajt, ky funksion shtesë i parashikuar nga VKM-ja e tetorit 2013 është në kundërshtim me ligjin.

"Nuk më duhet VKM-ja, unë bazohem tek ligji," tha ai.

Edhe ish-zv/ministrja e Mjedisit, Oljana Ifti – e cila në vitin 2014 drejtonte Komitetin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe e ka firmosur vendimin qarkullues, e cilësoi atë pa fuqi ligjore.

"Komiteti nuk ka qenë vendimmarrës, por koordinues," tha Ifti.

Dy anëtarët e tjerë të Komitetit – Gjon Radovani dhe Dritan Hila i thanë BIRN se nuk e mbanin mend mbledhjen.

Ndërkohë, Manjani pretendoi se në mbledhjen e 5 shkurtit 2014, e cila ka zgjatuar disa orë, me ndërprerje pushimi në mes për shkak të diskutimeve, kishte qenë prezent edhe sekretari i përgjithshëm i Kryeministrit, Ëngjëll Agaçi, i cili sipas Manjanit kishte insistuar që ai ta firmoste këtë dokument. Megjithatë, prezenca e Agaçit nuk mbështetet nga kujtesa e anëtarëve të tjerë të Komitetit. Drejtuesja e tij, Oljana Ifti i tha BIRN se në mbledhje nuk ka qenë prezent Sekretari i Përgjithshëm, por Artur Metani – që mbante në atë kohë detyrën e drejtorit të Departamentit Rregullator dhe të Përputhshmërisë në Kryeministri. Ifti e quajti Metanin "i dërguar nga Agaçi".

Vetë Metani tha se nuk e mbante mend mbledhjen konkrete, pasi tha se merrte pjesë në shumë mbledhje të tilla në atë kohë. Isaraj dhe Radovani mohuan që Ëngjëll Agaçi të ishte pjesë e mbledhjes, ndërsa vetë Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave nuk ishte i arritshëm për koment.

Vendimi pa bazë shkencore

Sipas ekspertëve mjedisorë të konsultuar nga BIRN, shpallja e emergjencës mjedisore kombëtare në shkurt 2014 nga Komiteti për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, jo vetëm nuk kishte bazë ligjore, por edhe nuk

mbështetej në të dhëna shkencore.

Në një analizë të vendimeve institucionale që çuan në shpalljen e kësaj emergjence, Rodion Gjoka, ekspert pranë Njësisë së Menaxhimit të Mjedisit Urban në Institutin për Zhvillimin e Habitatit (Co-Plan), i tha BIRN-it se racionalja teknike mbi të cilën supozohet që të jenë inspektuar indikatorët mjedisorë rezultojnë të jetë vizuale dhe jo-shkencore.

"Relacioni apo raporti, i cili ka nisur kërkesën për shpalljen e emergjencës mjedisore nuk është bërë transparent," tha Gjoka, duke ngritur pikëpyetje për indikatorët ku është bazuar Komiteti.

Vëzhgimi vizual nuk e hedh poshtë gjendjen e rënduar të mjedisit, sipas ekspertit, por "nuk orienton vendimmarrjen e autoriteteve drejt një zgjidhjeje të duhur".

Sipas Gjokës, vendimi i Komitetit mund të jetë nxitur nga nevoja për të justifikuar propozimin e pakërkuar për të ndërtuar inceneratorin e Elbasanit, nëpërmjet një procedure koncesionare.

"Këtu mendoj që është vepruar qëllimisht për të legjitimuar një iniciativë të pakërkuar, si ajo e ndërtimit të inceneratorëve, e cila në vetvete nuk mund të jetë prioritet, kur në hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve listohet e fundit," shtoi ai.

Aktivistët mjedisorë ankohen se hapat administrativë të njësisë të qeverisjes vendore për ndërtimin e inceneratorëve – të cilat kanë ndjekur vendimin e Komitetit ndërmëntor të shkurtit 2014, kanë qenë njësoj të debatueshëm.

"Asnjëherë nuk jam thirrur për të marrë pjesë në ndonjë dëgjese publike për këtë qëllim," tha Ahmet Mehmeti, kryetar i Klubit Ekologjik në Elbasan.

"Organet e pushtetit lokal dhe qendror, kur bie fjala për menaxhimin e integruar të mbetjeve, flasin vetëm për inceneratorë dhe asnjëherë të vetme për riciklimin e mbetjeve," përfundoi ai.



Kryetarja e komisionit hetimor parlamentar, Jorida Tabaku duke lexuar raportin e pakicës. Foto: LSA

Ëndrrat e liderit rus për pushtimin perandorak kanë tronditur Perëndimin, por në këtë anë të Evropës, ne kemi kujtime të gjata dhe e dimë se çfarë janë të aftë të bëjnë diktatorët hakmarrës.

Analizë

Ne evropianolindorët s’jemi të habitur nga planet brutale të Putinit

GAZMEND KAPLLANI | BIRN | ÇIKAGO

Ditën që Rusia pushtoi Ukrainën, unë po jepja mësim në klasën time: “Tales of political dystopia: storytelling after the Berlin Wall”. Ky është një mësim që eksploron marrëdhënien midis shkrimit dhe historisë në Evropën Juglindore dhe Lindore.

Sapo kishim mbaruar së lexuari “Sarajevo Marlboro” të Milenko Jergovic dhe gjenocidin boshnjak, dhe unë isha gati të prezantoja romanin “Primeval and Other Times” të Olga Tokarczuk.

Historia zhvillohet në një fshat mitik rural polak të quajtur Primeval: një vend paradoksal, njëkohësisht në skajet dhe në udhëkryqin e shekullit të 20-të të egër të Evropës.

Ajo që e sjell Primevalin në qendër të historisë janë pushtimet dhe luftërat e përgjakshme nga fuqitë e mëdha perandorake që rrinë pezull mbi Evropën Lindore – Rusia dhe/ose Gjermania.

Njerëzit e Primevalit bëhen të mbijetuar të luftërave, fatkeqësive dhe regjimeve totalitare. Prandaj, si të gjithë të mbijetuarit, ata nuk marrin asgjë si të mirëqenë dhe ky qëndrim formon perceptimin dhe imagjinatën e tyre për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen.

Primeval mund të shihet si një metaforë për të gjithë Evropën Lindore. Czeslaw Milosz, emigranti i famshëm polak dhe laureat i çmimit Nobel, shkroi se tipari më i spikatur i letërsisë evropiane lindore, në krahasim me letërsinë evropiane perëndimore, është ndërgjegjësimi i saj për historinë. “Kjo për shkak se koha lidhet me një rrezik që kërcënon ekzistencën e një komuniteti kombëtar të cilit i përket shkrimtari”, shkroi ai.

Ata që nuk marrin asgjë si të mirëqenë dhe përballen me rrezikun e zhdukjes personale dhe kombëtare, janë të gatshëm të rezistojnë dhe të luftojnë kundër të gjitha mosmarrëveshjeve. Ashtu siç po bëjnë ukrainasit këto ditë: Kievi mund të bëhet Sarajevo e ardhshme – ose Primevali.

Kam përshtypjen se Mao ishte diktatori i fundit që tërhoqi po aq vëmendje sa Vladimir Putin këto javët e fundit. Historianë, akademikë, gazetarë, politikanë të gjithë po përpiqen të analizojnë, dekodifikojnë dhe kuptojnë sjelljen dhe motivet e Putinit.

Diktatorët ndryshojnë mes tyre, por kanë disa ngjashmëri. Koha në pushtet është një faktor vendimtar. Me kalimin e kohës, diktatori bëhet më i izoluar dhe i pakontrolluar.



Foto ilustruese: Pixabay.

Kur diktatori vendos të vdesë në pushtet, i veshur me lavdinë perandorake, ky është momenti kur ai hyn në mbretërinë e monstroozitetit – që do të thotë se ai ka vendosur ta detyrojë realitetin t’i bindet urdhrave, ideve dhe dëshirave të tij.

Faza e fundit e çdo diktature të tillë vulozet nga aktet e shkatërrimit në masë dhe vetë-shkatërrimit. Megjithatë, diktatori Putin përbën një “risi” të veçantë: ai është një hibrid i carëve, Stalinit dhe bosit të mafias post-sovjetike. Kjo përzjerje e bën atë edhe më të rrezikshëm dhe të paparashikueshëm se paraardhësit e tij sovjetikë. Ai është shumë i ngjashëm me Xhokerin imagjinar sesa Leonid Brezhnev i vërtetë.

Gjithsesi, asnjë diktator nuk mund të “kuptohet” pa idetë dhe narrativat që i trajtojnë dhe i bëjnë të ndihen se kanë të drejtë për pushtet absolut dhe të pakufizuar.

Ish-kancelarja gjermane Angela Merkel komentoi një herë sjelljen “e çuditshme” të Putinit, kur, gjatë një prej takimeve të tyre në Rusi, Putin thirri Labradorin e tij të zi në dhomë, duke e ditur mirë se Merkel kishte frikë nga qentë: “E kuptoj pse ai duhet ta bëjë këtë. Për të treguar se është burrë. Ai ka frikë nga vetë dobësia e tij. Rusia nuk ka asgjë, nuk ka politikë apo ekonomi të suksesshme. E vetmja gjë që kanë ata është kjo.”

Merkel dhe Putin janë të dy “fëmijë” të Luftës së Ftohtë. Dallimi kryesor është se Merkel ka nxjerrë mësim nga Lufta e Ftohtë dhe më pas ka jetuar në një vend me politikë dhe ekonomi të suksesshme. Në vend të kësaj, Putini krijoi një dëshirë të pangopur për t’u hakmarrë dhe për të larë hesapet për humbjen e Ruisë dhe

politikën dhe ekonominë e shkatërruar. E vetmja gjë që ka ai dhe që mund ta lërë pas si trashëgimi tani është kjo: hakmarrja e tij e lavdishme.

Lufta barbare e Putinit i zuri në befasi shumë në Perëndim. Disa thanë se Putini ishte provokuar nga shtrirja e NATO-s në Lindje. Ky lloj diskursi tregon se edhe tani, vendet dhe njerëzit e Evropës Lindore trajtohen si subjekte pasive që nuk kanë të drejtë të vendosin vetë për fatin e tyre. Për më tepër, tregon pak kuptim të historisë dhe diktatorëve. Duket se udhëheqësit e Evropës Perëndimore i shihnin dhe i shohin ende diktatorët si Putini si fëmijë të llastuar, të cilët mund të qetësohen sapo t’u plotësohen tekat.

Si pasojë, gjatë gjithë këtyre viteve që ai po provokonte tekat e tij diktatoriale – duke vrarë disidentë në vendin e tij, duke pushtuar territore jashtë vendit, duke kërcënuar me hakmarrje ndaj vendeve si Mali i Zi për anëtarësimin në NATO – ata vazhduan ta trajtonin Putinin si një zotëri, një gjeni të frikshëm dhe një partner ekonomik, duke e lejuar atë të fitojë pushtet absolut në vend dhe të bëhet një ikonë globale e Perëndimit anti-liberal jashtë vendit.

Megjithatë, evropianolindorë e dinin se “tekat” e Putinit ishin të pakufishme. Për ta, tekat e Putinit kërcënojnë drejtpërdrejt demokracitë e tyre të reja dhe të brishta dhe ekzistencën e tyre kombëtare. Ata mbartnin një vetëdije për historinë që në Evropën Perëndimore duket se është zbehur dhimbshëm.

Ajo që liderët e Evropës Perëndimore refuzojnë të kuptojnë, edhe tani, është fakti se diktatorët hakmarrës dhe bosët e ma-

fias të nxitur nga ëndrrat perandorake si Putini nuk mund të jetojnë, të mbijetojnë dhe të manipulojnë masat pa armiq, luftëra dhe hakmarrje e trofe perandorak.

Të besosh në bashkëjetesën paqësore të botës demokratike me regjime si ai i Putinit është ndër iluzionet më të rrezikshme. Nuk do të ketë paqe në Ukrainë, Evropë dhe botë për sa kohë që Putini dhe ëndrrat e tij hakmarrëse perandorake do të sundojnë Rusinë.

Kjo është arsyeja pse kjo luftë nuk ka të bëjë vetëm me Rusinë, Ukrainën dhe Evropën. Fakti që një turmë e larmishme nostalgjikësh sovjetikë/bolshevikë, urretës të indinjuar të perëndimit dhe supremacistë të bardhë të të gjitha llojeve, fundamentalistë të krishterë, nacionalistë supremacistë, kleptokratë dhe autoritarë të të gjitha vendeve tani ndihen të shqetësuar nga mendimi se Rusia e Putinit mund ta humbasë luftën, tregon shumë për atë që është në rrezik në Ukrainë.

Hannah Arendt shkroi se problemi i së keqes do të ishte çështja themelore e jetës intelektuale të pasluftës në Evropë – pasi vdekja u bë problemi themelor pas luftës së fundit. Për fat të keq, ja ku jemi përsëri.

Shpresoj të jemi në gjendje të përballemi dhe t’i kapërcejmë sfidat dhe vështirësitë e ardhshme morale, politike dhe ekonomike me qëndrueshmërinë dhe mençurinë e banorëve të Sarajevës dhe Primevalit – duke mësuar se si të mos marrësh më asgjë si të mirëqenë. Lufta në Ukrainë do të formësojë vendet e mëdha dhe të vogla dhe secilin prej nesh, të pasur dhe të varfër, në Evropë dhe në botë për brezat që do të vijnë.

Kryeministri Edi Rama dhe portalet që e mbështesin po i frynë teorive të komplotit putinist në lidhje me protestat në Tiranë. Ndërsa policia prangos në mënyrë të paligjshme dhe të pamëshirshme protestuesit, ushtria e propagandistëve është hedhur në sulm nga zyrtarët e shtetit - ku paguhen si drejtorë apo këshilltarë, në një skemë që dukshëm ka elemente putiniste dhe antidemokratike.

Dizinformim dhe propagandë: Lufta hibride e Edi Ramës kundër demokracisë

GJERGJ EREBARA | BIRN | TIRANË

Kryeministri Edi Rama zgjodhi të përballet me zemërimin populor të shkaktuar nga rritja e çmimeve duke hedhur në fushëbetë artillerinë e rëndë të propagandës dhe dizinformimit.

Duke u mbështetur nga një rrjet portalesh - disa anonime dhe disa jo edhe aq anonime, qeveria po përpiket t'i etiketojë protestuesit që kanë mbushur sheshet si armiq të vendit, shërbëtorë të Putinit apo agentë të tij. Pjesa më me madhe e këtyre postimeve të maskuara si lajm [link] janë pa autorë, ndërsa në disa raste firmosen nga 'gazetarë' të cilët aktualisht rezultojnë të punësuar në shtet.

Fillimisht ishin portalet pranë qeverisë, të cilat, në mënyrën tipike të dizinformimit hodhën në lëmin e debatit publik mbi luftën Ukrainë fjalët kyçe: Putin, financim, destabilizim, agjenturë, e të tilla, deri sa gjetën një ngjarje që mund ta manipulonin në favor të narrativës së tyre.

Në njërin prej protestave kundër qeverisë, një qytetar doli me një pankartë ku shkruhej: "Sanksionet ishin për ne apo për Rusinë!". Ky slogan i hapi rrugën një numri artikujsh me tituj: "Parrulla kundër perëndimit në Tiranë, "Shtëpia e Lirisë" kundër sanksioneve ndaj Rusisë". [link]

Kjo narrativë e pambështetur në fakte u amplifikuar me 'opinione/komente' për "interferencat ruse", në shkrime që gati ngjanin 'copy-paste'.

Pastaj në lojë na u hodh vetë kryeministri, i cili, e plotësoi kuadrin e një fushate dizinformimi, duke pretenduar se kemi të bëjmë me një komplot. Një i tillë që sipas Ramës, "i shërben Putinit" - një shprehje që mbingashet e tij mediaticë e përkthyer në pyetje: Kush qëndron pas protestave në Shqipëri? Rama zbulon... Ose, akoma më drejtpërdrejtë duke pyetur: A ka lidhje Vladimir Putini...? Nëse i hedhim një sy databazës së pagave, "gazetarët" që ngrenë pyetjen e sinqertë "a ka dorë Vladimir Putin," rezultojnë se e marrin rrogën në ndonjë zyrë shteti.

Të hënën në darkë, Rama bëri një hap pas duke deklaruar se ai vetë nuk po akuzon protestuesit për spiunë rusë. "Nuk po diskutoj që këta i kanë nxjerrë në rrugë Putini, por po them si mund të bëhesh vegël edhe e një interesi tjetër," deklaroi ai.

Po nga buron gjithë kjo narrativë dizinformuese kundër të drejtës Kushtetuese për t'u tubuar paqësisht në Shqipëri?

Edi Rama është dukshëm në siklet, pasi u detyrua ta shpenzojë fundjavën për t'u

shfaqur në Facebook dhe televizione, duke iu përgjigjur njerëzve me një përzjerje të arrogancës, pranimit të fajit, sharjeve dhe aludimeve të pambështetura mbi fakte.

Sikletet e tij janë të shumëfishta. Prej gati një jave - kjo nuk është hera e parë, - në të gjithë vendin po mbahen protestesta, ku protestuesit mbajnë parrulla që e akuzojnë qeverinë për korrupsion. Ndryshe nga herë të tjera, këto parrulla e marrin kuptimin nga hendeqja që ka krijuar pabarazia dhe rritja e çmimeve në tregun shqiptar - i cili kontrollohet dhe manipulohet nga oligarkët pranë qeverisë.

Rama u përgjigjet akuzave për korrupsion duke thënë se kritikët janë "hajdutë impotentë", pa shpjeguar se çfarë nënkupton me këtë. Ndërsa rreket t'i përgjigjet realitetit të pabarazisë - e cila në Shqipëri duket se është shkaktuar pjesërisht nga korrupsioni dhe pjesërisht nga të ardhurat e paligjshme të krimit të organizuar, duke shpallur "përgjysmimin të kuotave të karburantit" për zyrtarët e shtetit.

Si një formë subkoshience, ministrja e tij, Belinda Balluku, u dëgjua në një video duke i thënë grosistëve të naftës se ajo ka frikë se mos protestuesit i vënë zjarrin benzinarëve, ndërsa sugjeronte se refuzimi i tyre për të sakrifikuar fitimet në mbrojtje të qeverisë, i bën ata "flamurtarë të revolucionit". Edhe Rama dukshëm ka frikë se mos revolta e çmimeve kthehet në një shkëndijë për të ndezur "revolucionin" kundër qeverisjes së tij apo elitës qeverisëse. Ai sugjeroi në një rast se ka ditur të reflektojë për "gabimet" e Rilindjes së tij në rast

protestash, duke iu referuar banorëve të Kukësit dhe kryengritjes së tyre kundër taksës private në Rrugën e Kombit.

Ndoshta, kur Rama flet për "hajdutë impotentë" po nënkupton një teori që dëgjohej shpesh në korridoret e pushtetit, sipas të cilës populli në thelb është gjithashtu hajdut, por që nuk ka mundësi të vjedhë dhe i sheh me zili dhe smirë liderët e tij. Por rasti i Kukësit na ngre pyetjen nëse kryeministri pret që vendi të digjet edhe një herë para se ai të reflektojë se ka apo jo ndonjë gjë gabim - një standard i ulët dhe ogurzi për Shqipërinë.

Problemet me të cilat përballet Rama sot nuk lidhen me krizën e shkaktuar nga Lufta në Ukrainë, siç lodhet të propagandojë ai dhe portalet që e mbështesin.

Pabarazia e shkaktuar nga korrupsioni dhe fitimet e paligjshme të krimit të organizuar kanë krijuar një ngërç ekonomik dhe social në vend. Korrupsioni është aq masiv, sa pasi qeveria derdhi mbi 600 milionë euro në investime publike, nuk ka ende pothuajse asnjë rrugë të përfunduar. Një keqmenaxhim i tillë vështirë se mund të krijojë rritje ekonomike, e aq më pak, vende pune me mirëqenie dhe paqe sociale.

Shqipëria ka sot taksat të larta mbi karburantet dhe si rrjedhojë çmim të lartë. Ky nuk është çmimi më i lartë në Evropë por ka gjasa që është një nga më të lartit në krahasim me të ardhurat. Çmimi dhe taksat e karburantit nuk mund të jenë thjeshtë një diskutim populist i llojit: "nuk më pëlqen që kushton shtrenjtë". Në thelb ky është edhe një debat ekonomik.

Një vend turistik, një ekonomi në zhvillim si e jona, ka nevojë për një çmim energjie sa më të lirë në mënyrë që të ketë qarkullim më të lartë ekonomik. Shkaku se pse taksat e karburanteve janë kaq të larta në Shqipëri lidhet me paaftësinë e qeverisë për të mbledhur taksat gjetkë.

Rritja e taksave të karburanteve ka qenë metoda e parapëlqyer e Ramës dhe e qeverisë para tij, për shkakun e thjeshtë se nafta importohet dhe taksat mbi naftën mbahen që të gjitha në doganë. Shqipëria nuk ka barrë të ulët fiskale, por pjesa tjetër e taksave apo sigurimeve shoqërore, kërkojnë ca më shumë punë dhe administratë publike profesionale dhe jo e përbërë nga patronazhistë partie në mënyrë që të funksionojë.

Këto probleme që ai ka krijuar bashkë me paraardhësit e tij në atë pozicion, vështirë se do të kapërcehen me "përgjysmimin të kuotës së karburantit" për drejtorët dhe akoma më vështirë që të luftohen me fushata dizinformimi që akuzojnë protestuesit për spiunë rusë.

Në të gjithë kontinentin Evropian, vetëm në Rusinë e Putinit dhe në Shqipërinë e Ramës, protestuesit arrestohen në protesta paqësore, ndërsa grupimet e shoqërisë civile dhe media e pavarur akuzohen për agentë të huaj.

Protesta që po bëjnë shqiptarët nuk kanë lidhje me luftën në Ukrainë, por rrjedhin nga konflikti midis popullit dhe oligarkisë, një përballje që çdo ditë dhe më shumë po vendos në peshore jo vetëm kontrollin mbi pasuritë publike, por edhe të drejtat Kushtetuese dhe demokratike.



Qytetarë në protestë kundër korrupsionit në Tiranë më 14 mars 2022. Foto: LSA

ANALIZË

Çmimi i energjisë elektrike në Shqipëri fryhet nga humbjet dhe koncesionet

Ka disa faktorë që përcaktojnë çmimin e energjisë elektrike që qytetarët dhe bizneset detyrohen të paguajnë në vende të ndryshme. Ky është një shpjegim i shkurtër për faktorët e kostove në Shqipëri.

GJERGJEREBARA | BIRN | TIRANË

Kryeministri Edi Rama dhe ministria Balluku duket se po përhap panik, jo shumë të arsyeshëm për një skenar apokaliptik, me çmime energjie prej 60 lekësh për kWh apo një botë të cilës i mungon furnizimi i rregullt me naftë. As Rama dhe as Balluku nuk kanë dhënë ndonjë burim informacioni se ku i mbështesin deklaratat të tilla. Për këtë shkak, ndoshta ia vlen të shohim se si qëndron puna me kostot dhe çmimet e energjisë elektrike në kontinentin evropian dhe se çfarë e bën një vend të ketë çmim energjie më të lartë se sa një tjetër dhe se, çfarëdoj krahassimi mes Shqipërisë dhe, fjala vjen, Italisë, nuk bën shumë sens.

Në gjysmën e parë të vitit 2021, familjet gjermane paguan 0.32 euro për kilovat-orë energji elektrike të konsumuar, duke qenë vendi me energjinë më të shtrenjtë në kontinent. Nga ana tjetër, familjet në Ukrainë paguan më pak se 0.05 euro për kWh. Sipas të dhënave të Eurostat, mesatarja e Bashkimit Evropian është 0.22 euro për kWh. Shqipëria nuk gjendet në këtë listë për shkak se “të dhënat mungojnë”, por çmimi aktual i miratuar, 11.08 lekë për kWh, ose afërsisht 9 cent, e vë Shqipërinë diku në mes.

Po çfarë e shkakton diferencën e çmimit nga Ukraina në Gjermani?

Zakonisht kostot e sektorit të energjisë elektrike ndahen në tre hallka, prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja. Kostot e transmetimit dhe shpërndarjes janë në përgjithësi të përafërta ndërsa kostot e prodhimit janë më të larmishme. Prodhimi i energjisë elektrike kryhet nga burime të ndryshme, si qymyri, gazi, nafta, uji, dielli, era apo energjia biotermale.

Zakonisht kostoja e prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet e qymyrit është e ulët, por ndotja e shkakton nga qymyri është shumë e lartë, kështu që shtetet në përgjithësi janë përpjekur të pengojnë përdorimin e qymyrit duke rritur taksat mbi këtë lloj energjie. Burimi tjetër i lirë për prodhimin e energjisë elektrike është energjia bërthamore, e cila, përveçse është e lirë, nuk shkakton ndotje në emetimin karboni. Problemi është se me këtë energji rreziku për aksidente është i lartë. Burimi tjetër i lirë i

prodhimit janë hidrocentralet. Hidrocentralet kanë kosto të konsiderueshme ndërtime por kosto operacionale minimale. P.sh., kostoja e energjisë së prodhuar në kaskadën e Drinit është afërsisht 1 lek për kWh. Problemi është që hidrocentralet nuk janë pa fund dhe në planet janë të pakta vendet që mund të mbështeten te hidroenergjinë për mbulimin e një pjese domethënëse të konsumit. Brazili është një nga të paktat vende që është në gjendje të mbulojë afro 70% të konsumit me hidro, por kjo shpjegohet me faktin që Brazili është vendi i Amazonës, lumit më të madh në planet.

Nafta dhe gazi janë burime më të shtrenjta për prodhimin e energjisë elektrike, pasuar, deri së fundmi, nga era dhe dielli. Në Gjermani, një vend që prej dekadash tashmë ka qenë pararojë e promovimit të energjisë së gjelbër, konsumatorët paguajnë çmim të shtrenjtë me qëllim që të subvencionohet përmes një skeme të njohur si Feed-In, energjinë e rinovueshme të prodhuar kryesisht nga era.

Gjermania ka aktualisht një çmim kaq të lartë të energjisë elektrike për shkak të politikave të ndërmarra më herët. Gjermanët kanë vendosur të fikin termocentralët bërthamorë në favor të energjisë së gjelbërt dhe gazit ndërsa shtrenjtimi i gazit gjatë këtij viti, ka shkakuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Në janar, gjermanët paguan 36 cent të euros për kWh, e barazvlefshme kjo me 44 lekë për kWh. Ndonëse ky është me të vërtetë një çmim shumë i lartë, duhet të

kemi parasysh se shteti gjerman ka pasur mundësi të ndjekë politikën që ka ndjekur, (mbyllja e termocentraleve bërthamore dhe promovimi i energjisë së pastër), për shkak se Gjermania është një vend i pasur. Me pagë minimale prej 1584 eurosh në muaj, çmimi i energjisë elektrike në Gjermani është krahasimisht më i ulët në raport me të ardhurat, se sa në Shqipëri.

Në anën tjetër të grafikut, Ukraina, me çmim gati dy herë më të ulët se sa Shqipëria, dukshëm e realizon këtë duke u mbështetur te energjia bërthamore dhe te termocentralet e qymyrit për prodhimin e energjisë elektrike, dy burime të lira, të cilat ky vend i ka, të parin, pra energjinë bërthamore, për shkak se qëlloji që Bashkimi Sovjetik ndërtoi termocentralet bërthamore atje dhe së dyti, (termocentralet e qymyrit) sepse qëlloji që në territorin e këtij vendi ka qymyr. Ukraina realizon rreth 60% të prodhimit energjetik të vendit me centrale bërthamore. Ukraina duket se mban çmim kaq të ulët të energjisë elektrike dhe për një shkak tjetër: Si vendi më i varfër në Evropë, me pagë minimale 190 euro në muaj, Ukraina dukshëm nuk ka mundësi të ndjekë politikën mjedisore dhe, as që të rrisë çmimin e energjisë për të mbuluar qoftë edhe kostot e prodhimit me qymyr apo me termocentrale bërthamore.



Jo energji për ngrohje

Kryeministri Edi Rama, i cili është angazhuar në një fushatë të pazakontë alarmiste në lidhje me mungesën e energjisë elek-




Kryeministri Edi Rama dhe ministria e Energjisë Belinda Balluku në Tiranë më 17 janar 2022. Foto: Gent Shkullaku/LSA

trike dhe furnizimit me naftë, paraqiti një faturë energjie elektrike në masën 600 euro të lëshuar në Itali. Një numër shqiptarësh me banim në Itali e kundërshtuan duke treguar faturat e tyre, në rendin e 30 apo 40 eurove në muaj. Ndërsa Rama e tregoi këtë si shembull se energjia elektrike në Itali është shumë e shtrenjtë dhe për rrjedhojë, shqiptarët nuk duhet të qahen, fakti është që në Itali, çmimi i energjisë elektrike vitin e kaluar ishte 22 cent të euros për kWh, shifër kjo shumë më e lartë se sa Shqipëria, 9 cent. Megjithatë, as në rastin e faturës 600 euro dhe as në rastin e faturës 30 euro, kjo nuk do të thotë ndonjë gjë të madhe, qoftë edhe për shkakun e thjeshtë se në Itali dhe në shumicën e vendeve evropiane, që nga vitet 1970, bota ka marrë masa për të kursyer energji. Një nga masat më popullore ka qenë zëvendësimi i energjisë elektrike si burim për ngrohje, gatim dhe për ujë të ngrohtë me gazin. Në Itali, një rrjet gazi me tubacione shkon në çdo shtëpi pasi gazi vjen, në pjesën më të madhe, nga Algjeria me tubacione nën Mesdhe. Ndërsa italianët heqin gatimin, ngrohjen dhe ujin e





Niveli i humbjeve aktuale dhe të pritshme



ngrohtë me gaz, përdorimi i energjisë elektrike mbetet vetëm për ndriçim, televizor apo kompjuter dhe lavatriçe. Nga të gjitha këto përdorime, vetëm lavatriçja është konsumator i konsiderueshëm i energjisë ndërkohë që poçat modernë për ndriçim apo televizorët e kompjuterat janë përdorues të sasive shumë të pakta të energjisë.

Arsyeja se pse vendet evropiane kanë zëvendësuar me gaz përdorimin e energjisë elektrike është se në këto vende, gazi digjet

në termocentrale për të prodhuar energji elektrike, e cila nga ana e saj, mund të përdoret për ngrohje apo gatim. Për rrjedhojë, është më e arsyeshme që gazi të përdoret drejtpërsëdrejti për ngrohje a gatim pa u konvertuar fillimisht në energji elektrike. Kursimet janë të jashtëzakonshme, qoftë edhe për faktin që gazi, duke u konvertuar në energji elektrike, humbet 30-40 për qind. Por ka edhe vende të cilave kjo logjikë nuk u funksionon. Në Norvegji, një vend prodhues madhor i gazit në Evropë, gatimi kryhet me elektricitet, i cili sigurohet nga hidrocentralet e panumërt që gjenden në lumenjtë e shumtë të këtij vendi. Me një fjalë, Norvegjisë i leverdis më shumë të përdorë energji elektrike nga burime hidro dhe të eksportojë gaz se sa anasjelltas. Norvegjia është vendi më i pasur në Evropë për sa i përket burimeve ujore dhe siguron 90% të prodhimit elektrik me hidro. Norvegjia prodhon 136 TWh energji në vit. Sa për krahasim, Shqipëria prodhoi vitin e kaluar 9 TWh, e gjitha nga hidrocentralet.

Llogaritë e thjeshta të Shqipërisë

Bota i kushtoi rëndësi të veçantë efikasitetit energjetike që nga kriza e naftës e viteve 1980. Kriza filloi në vitin 1973, kur një numër vendesh eksportuese të naftës në

Lindjen e Mesme vendosën të mos i shesin naftë botës perëndimore, si sanksion ndaj mbështetjes që Perëndimi i dha shtetit të Izraelit. Pas kësaj kohe, qeveritë filluan t'i kushtojnë vëmendje disa treguesve, të tilla si eficienta energjetike (sa energji konsumohet nga një pajisje për të të dhënë një rezultat të caktuar) dhe intensiteti energjetik (sa energji harxhohet për një dollar vlerë të shtuar në ekonomi), e llogaritur kjo jo vetëm për një pajisje apo për një ekonomi, por e ndarë në sektorë të ndryshëm.

Fakti që qeveria shqiptare nuk mban llogari të tilla është një tregues më vete por ky është një diskutim tjetër.

Ajo që vlen në këtë rast është që në çastin që eficienta energjetike mori rëndësi, vendet filluan të llogarisin se kur është e mundur dhe e arsyeshme që përdorimi i energjisë elektrike për gatim të zëvendësohet me gaz apo lokomotivat me naftë të zëvendësohen me lokomotiva me energji elektrike.

Llogaria e vetme e kësaj natyre në Shqipëri është bërë diku rreth vitit 2000, si pjesë e diskutimit të nevojës për të rritur çmimin e energjisë elektrike. Kjo ishte edhe koha kur në Shqipëri filloi të përdoret në një farë mase gazi i lëngshëm për ngrohje dhe për gatim.

Sa i përket të tjerave, asnjë lloj diskutimi nuk duket i nevojshëm. Shqipëria nuk ka qymyr dhe rrjedhimisht as energji elektrike ndotëse. Shqipëria është një vend tejet i vogël për të zhvilluar energji bërthamore. I vetmi burim i energjisë elektrike që përdor vendi janë hidrocentralet. Sa i përket energjisë fosile, Shqipëria importon rreth 630 mijë tonë nënprodukte naftë dhe eksporton rreth 400 mijë tonë naftë bruto.

Problemi është se lumenjtë nuk janë të pafundëm. Shfrytëzimi i tyre për energji elektrike nuk siguron të gjithë nevojat e vendit sot, ndërsa në të ardhmen, nëse ekonomia do të rritet, siç shpresohet, atëherë konsumi i energjisë do të duhet të rritet dhe shtesa do të duhet të mbulohet nga burime të tjera.

Prodhimi i hidroenergjisë në Shqipëri ndahet në dy kategori të mëdha: njëra është prodhimi shtetëror i realizuar në Kaskadën e Drinit dhe tjetra është prodhimi privat i energjisë në hidrocentrale me koncesion apo të privatizuara. Kostoja e energjisë së prodhuar në hidrocentralet publike, duke përfshirë edhe kostot e borxheve të vjetra është 2.3 lekë, por energjia e prodhuar nga sektori privat me kontrata koncesionare apo hidrocentrale të privatizuara është 8.6 lekë dhe ky çmim nuk varet nga kostot e prodhimit por nga kontratat e nënshkruara dhe rregulloret e vendosura nga qeveritë e ndryshme përgjatë 15 viteve të fundit.

Mesatarisht gjatë pesë viteve të fundit, Shqipëria ka mbuluar 83% të konsumit të vet me prodhim të vetin. Nga prodhimi i vet, afro 60% e energjisë është realizuar nga Kaskada e Drinit, me kosto të ulët dhe 40% nga hidrocentralet private apo ato me koncesion, ku çmimi është më i lartë.

Pjesa e mbetur, rreth 17% mesatarisht përgjatë pesë viteve të fundit, duhet të mbulohet nga importi. Çmimi aktual i importit të energjisë elektrike, sipas të dhënave të KESH, është 213 euro për MW/h ose 21.3 cent të euros për kW/h. Rrjedhimisht, kostoja që qytetarët do të paguajnë për energjinë është mesatarja e ponderuar e këtyre tre çmimeve, plus kostot e transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe, më e rëndësishmja, kostot e humbjeve të energjisë në rrjet. Ndërsa çmimi 213 euro për 17% të energjisë elektrike mund të mos duket si faktor veçanërisht i rëndë, duhet të kemi parasysh se prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri është i luhatshtëm. Deficiti mesatar shumëvjeçar është 17% por në një vit, prodhimi vendës mbuloi 112% të konsumit ndërsa në një vit tjetër, vetëm 61%. Me pak fjalë, nëse viti 2022 do të jetë një vit i keq për prodhimin e energjisë, shqiptarëve do t'u duhet të paguajnë 30 apo 40% të energjisë së konsumuar me çmimin mbi 200 euro për MW/h. Nëse ndodh kështu, Shqipërisë do t'i duhet të importojë 2 apo 3 TWh energji me një kosto totale prej 400-600 milionë eurosh. Kjo është një shifër e barabartë me të ardhurat totale të OSHEE-së përgjatë një viti. Në rast se deficiti do të jetë jo 40, por 20%, sërish kostoja shtesë do të jetë në rendin e 200 apo 300 milionë eurove ndërsa nëse shqiptarët do të kenë fat, atëherë mundet të mos kenë kosto shtesë.

Humbjet më shumë se sa deficit

Shqipëria ka pasur një deficit mesatar vjetor prej afro 1.2 TWh energji elektrike përgjatë pesë viteve të fundit, me luhate nga 2.9 TWh në vitin 2017 në plus 0.9 TWh në vitin 2018. Por ndërkohë, humbjet e energjisë elektrike janë luhatur në 1.6-1.9 TWh në vit, pra afërsisht 1.4 herë më të larta se sa deficit. Shkaqet e humbjeve të energjisë elektrike në masën 20% e të gjithë energjisë së hedhur në rrjet janë një mister i vërtetë në Shqipëri. Një botë, norma e zakonshme e humbjeve është 5% e energjisë së hedhur në rrjet. Zyrtarisht në Shqipëri dy të tretat e humbjeve janë teknike, pra për shkak të pajisjeve të rrjetit dhe jo vjedhje. Normalisht që sipas axhendës së vetë qeverisë aktuale të tetë viteve të shkuara, investimet në rrjetin e shpërndarjes së energjisë do të duhej të kishin sjellë reduktimin e humbjeve në 6% në vitin 2020, pra dy vjet më parë. Diferenca mes humbjeve në kuota normale 6% dhe asaj aktuale (13%) është e barabartë me 0.6 TWh, për të cilat, shqiptarët do të duhet të paguajnë afro 126 milionë euro për t'i importuar.

Edhe në humbjet joteknike, pra vjedhjet, situata është e ngjashme. Kuota e pranueshme është 2%, shifër kjo e dhënë në Planin e Rimëkëmbjes [link], ndërkohë që aktualisht janë në masën 6.3%. Diferenca është e barabartë me 72 milionë euro me çmimet aktuale të importit. Me pak fjalë, shqiptarëve do t'u duhet të paguajnë këtë vit gati 200 milionë euro për të zëvendësuar humbjet dhe vjedhjet në sektorin e energjisë.

Shënim: Konsumi i energjisë elektrike matet me vat në orë dhe me shumëfisha të saj, kilovat, megavat, gigavat apo teravat. Një poç eficient konsumon 6 vat në orë, ose afërsisht 0.07 lekë energji elektrike. Një kondicioner normal konsumon 1.5 kWh, me një kosto prej 16.6 lekësh në orë. Familjet shqiptare konsumuan sëbashku gjatë vitit të kaluar 3.1 miliardë kWh. Pjesa tjetër e ekonomisë, përfshirë institucionet publike dhe kompanitë private, konsumuan 3.54 miliardë kWh. Në rrjet u hodhën gjithsej 8.4 miliardë kWh, nga të cilat, 6.6 miliardë u faturuan dhe afërsisht 1.8 miliardë humbën.

ANALIZË

‘Krimet’ me koncesionet parashkruhen, ndërsa SPAK dremit mbi dosje

Vonesat e Prokurorisë së Posaçme me hetimin e koncesionit të sterilizimit të pajisjeve kirurgjikale kanë sjellë parashkrimin e një prej veprave penale të dyshuara, duke shmangur përgjegjësit e dyshuar nga ndëshkimi ligjor.

EDMOND HOXHAJ | BIRN | TIRANË

Më 23 dhjetor 2019, pak javë pas themelimit të Strukturës së Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, Nisma Thurje – një lëvizje qytetare që më vonë u transformua në parti politike, depozitoi një kallëzim dhe kërkoi vendosjen para përgjegjësisë penale të zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilit kishin nëshkruar kontratën koncesionare të sterilizimit të pajisjeve kirurgjikale me vlerë 100 milionë USD.

Në kallëzimin e depozituar në SPAK, Nisma Thurje ngre dyshime se zyrtarët publikë të përfshirë në këtë kontratë koncesionare të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 2015 kanë shkelur barazinë e pjesëmarrësve në tendera, kanë shpërdoruar detyrën dhe kanë kryer korrupsion pasiv duke përdorur pushtetin publik për përfitime private, si dhe i kanë sjellë dëm financiar në vlera të mëdha buxhetit të shtetit.

Një prej drejtuesve të “Nisma Thurje”, Panajot Soko e konsideron këtë procedurë koncesionare si një “katastrofë financiare”.

“Një shërbim i cili realizohej brenda një buxheti prej jo më shumë se 250 mijë euro në vit, sot kërkon një angazhim gati 80 herë më të lartë,” tha ai.

Prej dy vitesh, SPAK ka regjistruar një procedim lidhur me këtë kallëzim

për të tre veprat penale të denoncuar, përfshirë “shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”; “shpërdorimi i detyrës”; “korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” – por ende nuk ka evidentuar zyrtarët përgjegjës për kryerjen e tyre.

Të dhënat e siguruar nga BIRN tregojnë se hetimet nuk kanë avancuar përtej fazës paraprake, duke sjellë dhe parashkrimin e veprës penale “shkelja e



Ilir Rrapaj dhe kryeministri Edi Rama gjatë një takimi në pallatin e Brigadave në kuadrin e nismës “Thuaji Po Shqipërisë” | Foto nga : Facebook



Kreu i SPAK, Arben Kraja dhe drejtuesja e Byroës Kombëtare të Hetimit, Aida Hajnaj gjatë një konference. Foto: LSA

barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”; duke shmangur nga përgjegjësia penale personat që dyshohet se kanë shkelur ligjin dhe kanë krijuar kosto për taksapaguesit.

E pyetur nga BIRN mbi vonesat e hetimit të kësaj çështjeje, e cila përbën dhe kallëzimin e parë të regjistruar nga SPAK pas themelimit si institucion, Prokuroria e Posaçme tha se nuk mund të komentonte për shkak të ‘sekretit hetimor’.

“Ky procedim penal është në fazën e hetimeve paraprake dhe deri tani nuk ka ndonjë emër të shënuar në regjistrë si person nën hetim,” sqaroi koordinatori për mediat në SPAK, Xhuljeta Krasta.

Kontrata e sterilizimit të pajisjeve kirurgjikale është një prej 4 projekteve të Partneritetit Publik Privat me mbështetje buxhetore në sektorin e shëndetësisë, me zanafillë të programi i qeverisjes së kryeministrit Edi Rama pas ngjites së tij në pushtet në vitin 2013.

Kontrata u firmos në dhjetor 2015 mes ish-ministrit të Shëndetësisë, Ilir Beqja dhe kompanisë koncesionare Sani Service – aksionerët e së cilës janë Investital LLC dhe kompanitë italiane “Servizi Italia”, “Tecnosanimed” dhe “U.Jet S.r.l”.

Paketën më të madhe me 40 për qind të aksioneve e zotëron Investital LLC- një kompani asokohe e vogël e themeluar me kapital 1 mijë euro në Kosovë nga Ilir Rrapaj. Në një investigim të mëparshëm, BIRN zbuloi se Rrapaj u kthye në Shqipëri pas zgjedhjeve të vitit 2013 dhe para se të fitonte koncesionin, vendosi kontakte të shpeshta me ish-ministrin e Shëndetësisë, Ilir Beqaj.

Sipas një raporti të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pajisje me vlerë mbi 107 milionë lekë të blera nga qeveria shqiptare iu dhuruan koncesionarit pa pagesë dhe pa asnjë parashikim në kontratë.



Struktura e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, SPAK, e cila përbëhet nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, është një institucionet e reja të themeluara nga reforma në drejtësi e miratuar nga parlamenti në vitin 2015.

Ndërtimi i kësaj strukture synonte të rriste përpjekjet dhe efikasitetin e organit të akuzës në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, për të forcuar sundimin e ligjit në vend dhe përshpejtuar procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Ish-prokurori i Krimeve të Rënda, Anton Martini vëren se nga momenti i kryerjes së kallëzimit penal nga Nisma Thurje deri në dhjetor të vitit 2020, asnjë nga veprat penale për të cilat është regjistruar procedimi nuk ishte parashkruar.

“Çka do të thotë se mund të ushtrohej ndjekja penale ndaj cilitdo shtetas që do të rezultonte i implikuar në kryerjen e këtyre veprave penale,” sqaron Martini.

“Nga muaji dhjetor 2020 e në vijim rezultoi që vepra penale e ‘Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike’, parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal është parashkruar (referuar nenit 66, pika ‘ç’ të Kodit Penal) e për rrjedhojë, ndjekja penale ndaj shtetasve që mund të kenë kryer këtë veprë penale nuk mund të vazhdojë,” shtoi ai.

Martini sjell në vëmendje se vepra penale regjistruhet pasi prokurori vlerëson se prej materialit kallëzues ka vend të hetohet, pasi në faktet e parashtruar ka elementë të një ose disa veprave penale.

“Nëse nga materiali kallëzues nuk ka elementë të ndonjë veprave penale, prokurori brenda 15 ditësh vendos të mosfillojë procedimin,” shpjegoi Martini.

“Pas regjistrimit ka dy zgjidhje; njëra e pushon dhe tjetra regjistron emrin e personit/personave në regjistër, njofton akuzën dhe e dërgon për gjykim,” shtoi ai.

Shtatë vjet pas nënshkrimit, kontrata e sterilizimit të seteve kirurgjikale po i kushton gjithnjë e më shtrenjtë financave të shëndetësisë, ndërkohë që mjekët dhe kirurgët i kanë rikthyer sytë nga autoklavat e vjetra për të kryer detyrën dhe mbajtur kostot nën kontroll.

“Pamundësia financiare e spitaleve për të përballuar financiarisht kostot e ndërhyrjeve kirurgjikale, për shkak të këtij koncesioni, ka bërë që të reduktohen rastet e ndërhyrjeve tek pacientët në nevojë, vetëm e vetëm prej pamundësisë financiare,” tha Soko.

“Shumë mjekë, në pamundësi për të kryer ndërhyrjet kirurgjikale për shkak të kostove, por edhe të pamundur për të mos i kryer ato për shkak të ndërgjegjes profesionale, kanë vendosur t’i kthehen metodës së vjetër të sterilizimit me autoklavat e vjetra,” përfundoi ai.

KLGGJ insiston se shkurtimi i gjykatave është projekt ‘vizionar’

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë mbrojtën në një dëgjese publike me grupet e interesit projektin e hartës së re gjyqësore, duke insistuar se do ta bënte sistemin e drejtësisë më eficient.

BESARLIKMETA | BIRN | TIRANË

Më 11 mars, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë mbajtën seancën e fundit dëgjimore me grupet e interesit për draftin e hartës së re gjyqësore, e cila synon ta reduktojë numrin e gjykatave në vend nga 38 në 19.

“Ky draft është nga më të guximshmit dhe më vizionari,” pretendoi Brikena Ukperaj, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe njëherazi pjesë e grupit të punës për hartimin e hartës së re gjyqësore.

Duke folur përparë përfaqësuesve të shoqatave të biznesit dhe dhomave të tregtisë, Ukperaj theksoi se ligji ‘Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor’ vendoste kritere për numrin e gjyqtarëve që mund të kishte një gjykatë rrethi apo apeli.

Ajo tha se harta e re gjyqësore nxiste specializimin dhe eficientësinë e sistemit, duke i mbyllur gjykatat e vogla dhe duke i konsoliduar ato në seksionin të specializuar në rrethe e mëdha. Anëtarja e KLGGJ-së theksoi se të dhënat e analizuar nga grupi i punës – bazuar në dosjet e reja që regjistrohen në gjykata dhe jo çështjet e prapambetura – kanë treguar se gjykatat e vogla nuk janë eficiente.

“Një gjyqtar në Tiranë mban ngarkesë të barabartë me një gjykatë të vogël rrethi,” tha Ukperaj, duke shtuar se në kryeqytet kishte gjyqtarë që po shqyrtonin njëkohësisht deri në 1 mijë çështje gjyqësore.

Ukperaj insistoi se shkurtimi i numrit të gjykatave në vend, jo domosdoshmërisht e kufizonte aksesin e qytetarëve tek drejtësia.

“Duhet konceptuar gjykata jo si godinë, por si shërbim,” tha ajo.

Në dëgjese morrën pjesë edhe Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja dhe krye-

tarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Naureda Llagami.

Llagami theksoi në fljalën e saj përshëndetëse rëndësinë e konsultimeve me grupet e interesit për hartimin e një projekti të mirë për riorganizimin e sistemit të drejtësisë.

“Asnjë vendimarrje e madhe nuk duhet të merret pa u konsultuar dhe reflektuar shqetësimet tuaja,” tha ajo.

Llagami gjithashtu shpjegoi se grupi i punës për hartën e re gjyqësore kishte punuar për një periudhë 2 vjeçare për të analizuar indikatorët e sistemit dhe ishte asistuar nga Këshilli i Europës dhe USAID-i.

Ndërkohë, Ministri i Drejtësisë Ulsi Manja tha se pas procesit të konsultimit publik të draftit dhe reflektimit të sugjerimeve të grupeve të interesit, drafti do të dikskutohej me Prokurorinë e Përgjithshme dhe KLP-në, përpara se të dërgohej në Këshillin e Ministrave.

Manja theksoi se hartimi i hartës së re ishte një detyrim ligjor që KLGGJ dhe Ministria e Drejtësisë nuk mund ta shmangnin dhe nuk lidhej me procesin e vetingut dhe vakancat që ka krijuar.

“Këtu nuk bëhet fjalë për hartë të re, por për riorganizim,” tha Manja. “Riorganizimi nuk merr në konsideratë stokun e çështjeve dhe nuk diktohet as nga procesi i vetingut,” shtoi ai.

Gjatë fljalës së tyre përfaqësuesit e dhomave të tregtisë e vunë theksin në problematikat që has biznesi në gjykata administrative, stokun e madh të çështjeve të krijuara dhe afatet e zgjatura të shqyrtimit të tyre.

“Arbitrariteti dhe mosbatimi i ligjit krijojnë çështje gjyqësore,” tha Nikolin Jaka, kreu i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë. “Gjykata vendos në 90% të rasteve në favor të shtetit,” u ankua ai, duke ilustruar problematikën me të cilën përballen sipërmarrjet në gjykata administrative.



Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja dhe kryetarja e KLGGJ-së, Naureda Llagami gjatë prezantimit të hartës së re gjyqësore. Foto:LSA

REPORTAZH

Gjuetia e paligjshme: Në liqenin e Fierzës nuk bie më ‘peshk në grep’

Peshkatarët e licesuar në liqenin e Fierzës kthehen shpesh me rrjeta të zbrazëta për shkak të rënies së sasisë së peshkut në liqen, që sipas ekspertëve vjen për shkak të peshkimit të paligjshëm dhe mungesës së menaxhimit të liqenit.



Një varkë peshkimi në bregun e liqenit të Fierzës. Foto: Bashkim Shala.

BASHKIM SHALA | BIRN | KUKËS

Dita nis ende pa gdhirë për vëllezërit Jasim e Hysen Manga, të cilët nisen me varkën e tyre nga bregu i Liqenit të Fierzës në fshatin Ramhas për të mbledhur rrjetat e vendosura një ditë më parë në mes të liqenit, në zonën ku dikur ka qenë i vendosur Kukësi i Vjetër. Puna zgjat disa orë, por rreth orës 9 të paradites, varka e tyre kthehet në breg me 4-5 peshq të rënë në rrjetë. Asnjë prej vëllezërve nuk e fsheh zhgënjimin. “Peshk nuk ka. E kanë dëmtuar shumë me dinamit. Janë njerëz të papërgjegjshëm. Përveç dinamitit po përdorin edhe korrentin përmes gjeneratorëve dhe e kanë shkatërruar peshkun krejt,” thotë i revoltuar Jasim Manga, i cili peshkon prej gati gjysmë shekulli.

Shqetësimin e tyre e ndan edhe Arben Palushi, ish-punonjës i Ndërmarrjes së Peshkimit në Kukës para viteve 90’ dhe aktualisht inspektor i Turizmit dhe Mjedisit në Bashkinë e Kukësit. Palushi thotë se nga 100-120 ton peshk në vit që kapej në Fierzë para viteve ‘90, tani zihen rreth 25 ton peshk ose pesë herë më pak.

Treguesit e liqenit të Fierzës bien në kontrast me të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë të publikuara nga INSTAT, sipas së cilave peshkimi në ujërat e brendshme të vendit dhe në liqene gati u dyfishua prej vitit 2016 deri në vitin 2020.

Fierza duhej të ishte pjesë e kësaj rritje, pasi është liqeni i katërt për nga sipërfaqja në Shqipëri.

Megjithatë, ekspertët theksojnë se ky aktivitet është dëmtuar nga peshkimi i paligjshëm, nga mungesa e organizimit të peshkatarëve lokalë si dhe nga mënyra e menaxhimit të liqenit të Fierzës nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, KESH.

Sfidat e menaxhimit

Në shtator 2019, një vendim i Këshillit të Ministrave e shpalli liqenin e Fierzës

hapësirë ujore me interes për peshkimin si dhe prezantoi një skemë bashkëmenaxhimi të liqenit mes Korporatës Elektroenergjitike, KESH dhe Organizatës lokale të Menaxhimit të Peshkimit, OMP.

Një muaj më vonë, ish-ministri i Bujqësisë, Blendi Çuçi mori pjesë në hedhjen e 160 mijë rasateve të krapit në liqen, ndërsa kryeministri Edi Rama, e cilësoi këtë një “punë për transformimin e ekonomisë rurale”.

Por ky mund të jetë rasti i fundit i hedhjes së rasateve në liqen, ndërsa OMP-ja lokale ende nuk funksionon.

Fadil Gjuta, ish-punonjës i Ndërmarrjes së Peshkimit në Kukës që nga themelimi i saj në vitin 1987 dhe aktualisht inspektor i Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës në Ministrinë e Bujqësisë i tha BIRN se për të rregulluar peshkimin në liqen duhet të hidheshin çdo vit rasate peshku.



Liqeni i Fierzës | Foto arkivë nga : BIRN

Gjuta shtoi se ky proces pengohet nga mungesa e Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit, e cila krijon probleme për investime shtesë.

“Ndryshe nga OMP-ja e Shkodrës, ajo e Kukësit nuk po funksionon,” tha Gjuta.

Palushi mendon se bashkëmenaxhimi e liqenit të Fierzës e pengon edhe nga shfrytëzimi i vazhdueshëm i ujit të liqenit për të prodhuar energji elektrike nga ana e KESH.

“Krizat energjetike si pasojë e dimrave të thatë dhe mungesës së shirave kanë bërë që liqeni i Fierzës të mos stabilizohet dhe peshkatarët herë gjuajnë në liqen, herë gjuajnë në lumë nga ulje -ngritjet e Liqenit,” tha Palushi.

Palushi thotë se lëvizjet e mëdha të nivelit të ujërave për shkak të shfrytëzimit të HEC-it, dëmtojnë zinxhirin ushqimor të peshkut dhe nëse ato ndodhin mes 15 prillit dhe 15 majit, kohë e lëshimit të

vezëve, kjo e dëmton edhe më shumë popullatën e peshkut.

Specialistët thonë se efektet e këtij ndryshim të nivelit të ujërave mund të normalizoheshin vetëm nëse në liqen hidhet vazhdimisht rasat, siç ndodh aktualisht në liqenin e Ulzës dhe Shkopetit, nisur nga një marrëveshje mes kompanisë Kurum dhe peshkatarëve të zonës.

“Në liqenin e Ulzës dhe Shkopetit, kompania Kurum që ka në pronësi HEC-et, hedh çdo vit nga 100 mijë copë rasate. Hedhja e rasateve bëhet në bazë të marrëveshjes si zhdëmtim për ulje ngritjet e liqeneve nga shfrytëzimi i tyre nga Kurum. Kjo gjë nuk ndodh në Kukës me KESH-in,” tha për BIRN Ervin Ruçi, inspektor i peshkimit për qarqet e Kukësit dhe Dibrës.

Për shkak të kësaj situatë, ekonomia e peshkimit në Kukës është më shumë një shfaqje nostalgjie për të shkuarën.

Arben Palushi kujton se dikur, Ndërmarrja e Peshkimit në Kukës operonte në të gjithë hapësirën e liqenit nga Skavica deri në digën e Fierzës dhe kishte mbi 5 mijë hektarë për të peshkuar.

Asokohe, sipas Palushit aty kishte edhe një repart për mirëmbajtjen dhe riparimin e rrjetave të peshkimit, kishte një anije peshkimi si dhe 26 varka, pesë prej të cilave ishin me motor.

Peshkimi i paligjshëm

Mungesa e menaxhimit dhe e një aktiviteti të mirëfilltë peshkimi në liqenin e Fierzës i ka lënë hapësirë peshkatarëve të paligjshëm, të cilët gjuajnë me eksplozivë apo me korrent.

Destan Dina peshkon prej 20 vitesh në zonën e liqenit ku derdhet Drini i Bardhë dhe zotëron gjithashtu një restorant me produkte peshku në qytetin e Kukësit. Ai ankohet se peshkatarët e paligjshëm po e dëmtojnë edhe më tej liqenin, por askush nuk vepron.

“Gjuajtja me dinamit nuk është një gjë



Aktori që imiton Ramën bëhet fytyra e protestave që po trondisin Shqipërinë

Aktori i humorit Florjan Binaj, i famshëm për imitimin e kryeministrit Edi Rama në televizion, është bërë për ironi të fatit një nga protestuesit më të zhurmshëm kundër qeverisë së Ramës.

FJORI SINORUKA | **BIRN** | TIRANË

Në një nga rolet e tij të shumta humoristike në televizion, Florjan Binaj imiton kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama.

Megjithatë, të shtunën më 12 mars, ai përdori mikrofonin e tij për një qëllim paksa ndryshe – për të udhëhequr protestat në rrugë kundër njeriut që ai imiton aq mirë.

Para zyrës së Ramës, Binaj iu bashkua mijëra shqiptarëve duke shprehur zemërimin e tyre për rritjen e paprecedentë të çmimeve, për të cilat autoritetet fajësojnë sulmin e Rusisë ndaj Ukrainës.

Rritjet e mëdha të çmimeve të ushqimeve, naftës dhe transportit kanë bërë më të vështirë jetën e shqiptarëve kohët e fundit dhe shumë prej tyre kanë dalë në rrugë për të treguar shqetësimin e tyre, ose po e bëjnë këtë në rrjetet sociale.

“Në Shqipëri nuk ka vend për profesionistë, vetëm për ‘patronazhistë’”, tha Binaj para turmës, duke iu referuar termit të përdorur për zyrtarët e Partisë Socialiste në pushtet, të cilët në zgjedhjet e përgjithshme të prillit të kaluar u angazhuan për të monitoruar votimin aktual në atë që disa e konsideruan një vëzhgim frikësues, i stilit të Big Brother.

Binaj mbante në duar një pankartë me dy foto.

Njëra ishte e kreut të Partisë Demokratike të opozitës, Lulzim Basha, së bashku me deklaratën e tij të fundit: “Nuk kam humbur kurrë asnjë zgjedhje” – një goditje e drejtpërdrejtë në humbjen poshtëruese të partisë në zgjedhjet e fundit vendore. Tjetra ishte e Ramës, bashkë me deklaratën e tij: “Nuk kam ngritur asnjëherë taksë”.

Protestat nuk janë “vetëm për rritjen e çmimeve”

37-vjeçari thotë se jo të gjithë e mirëpresin kur e shohin të udhëheqë një protestë kundër qeverisë.

“Kam pasur shumë kritika sepse protestoj”, tha ai për BIRN gjatë tubimit masiv në kryeqytet, ndërsa ftoi të gjithë kolegët e tij të marrin pjesë gjithashtu.

Binaj i tha BIRN se motivimi i tij për t’iu bashkuar protestave erdhi tetorin e kaluar, kur çmimet në vend filluan të rriteshin për herë të parë. “Unë kam protestuar që nga dita e parë: jo vetëm në këtë protestë, por edhe në protestën e tetorit 2021 – shkëndija e parë e problemeve që do të vinin dhe erdhën”, tha Binaj.

“Ajo protestë filloi për një rritje të çmimeve, por në thelb ka edhe betejën midis së vërtetës dhe gënjeshtërisë”, tha ai.

“Sa më shumë u hapen sytë njerëzve me të vërtetën, aq më shumë hi hidhet në sytë e tyre dhe u shpifet në vesh nga mekanizmi gjigant i qeverisë”, tha ai.

Që nga fillimi i raundit të fundit të protestave në mars, kryeministri i Shqipërisë Edi Rama ka këmbëngulur se rritjet janë

pasojë e luftës në Ukrainë dhe kritikoi njerëzit për ankesat e tyre. Rama madje tha se “i vjen turp që një vend i NATO-s nuk i kupton pasojat e luftës” në Ukrainë. Sipas Ramës, protestat i shërbejnë Rusisë dhe “vetëm Kremli i sheh me admirim”.

Protestuesit nga ana e tyre akuzojnë qeverinë për keqmenaxhim dhe fajësojnë oligarkët, duke pohuar se rritjet kanë pak të bëjnë me luftën në Ukrainë.

Protestat kundër rritjes së çmimit të bukës dhe karburantit nisën më 6 tetor 2021, kur avokati dhe aktivisti i shoqërisë civile Adriatik Lapaj shkroi në Facebook se synonte të mbante një protestë jashtë Kryeministrisë, “për të shprehur kundërshtimin tim ndaj rritjes së çmimit të bukës, gazit, naftës dhe energjisë elektrike”. Mijëra u bashkuan me të.

Protestat rifilluan në mars të këtij viti, kur çmimi i naftës u rrit në dy euro për litër.

Protestat u bënë edhe më të mëdha të shtunën, më 12 mars, kur qytetarët marshuan nga sheshi Skënderbej në qendër të Tiranës drejt Kryeministrisë.

“E vetmja opozitë tani në Shqipëri janë protestuesit”

Binaj tha për BIRN se ka përdorur edhe platformën e tij në rrjetet sociale dhe emisionin “Portokalli”, në të cilin ka punuar prej vitesh, për të përhapur mesazhin.

Ai gjithashtu mbështet fushatën e gjelbër “Vjosa Park Kombëtar Tani”, e cila kërkon që shteti të mbrojë një nga lumenjtë e fundit të egër në Evropë, Vjosën, nga një ndërtim i dëmshëm digave.

“Përfshirja ime në këtë është sepse jam rritur pranë atij lumi”, shpjegoi ai.

“Arsyeja tjetër është se unë jam një adhurues i natyrës. Nuk kemi pse të bëjmë mrekulli atje; paraardhësit tanë na e lanë trashëgim atë”, tha ai për median lokale ABC Neës, kur u pyet për përfshirjen e tij. “I kam shprehur mesazhet e mia në sheshin Skënderbej. Kam vite që jap mesazhe në ‘Portokalli’ dhe në rrjetet e mia sociale”, kujton ai.

“I bëj thirrje kolegëve të mi të bëjnë të njëjtën gjë – të guxojnë, sepse heshtja është e barabartë me pranimin e shtypjes”, tha ai.

Demonstratat e mëparshme ditore janë bërë më të rralla, por protestuesit kanë hartuar një listë kërkesash për publikun dhe

presin plotësimin e tyre deri të shtunën, kur mund të rifillojnë protestat.

Më kryesoret janë: heqja e taksave të ndryshme për karburantin – taksat e qeverisë për karburantet përbëjnë 53 për qind të koston përfundimtare – si dhe heqjen e përkohshme të TVSH-së për artikujt ushqimorë bazë; më shumë kompensim dhe mbështetje për fermerët; një paketë më e mirë krize për pensionistët, invalidët dhe familjet; dhe hetimin dhe mbikëqyrjen e koncesioneve dhe shpenzimeve nga buxheti i shtetit dhe të atyre forcave që mund të manipulojnë tregun.

“Kërkesat u bënë publike... i përcaktuan ekspertët, këto kërkesa janë bërë disa herë edhe gjatë protestave”, tha ai.

Më e rëndësishmja është “lehtësimi i taksave të naftës, sepse rritja e çmimit të naftës filloi reaksionin zinxhir të rritjeve në të gjitha çmimet e tjera”, tha ai.

Binaj shtoi se këtë moment e sheh si “historik”, duke pasur parasysh situatën e vështirë politike në vend.

Me opozitën kryesore, Partinë Demokratike, tani të ndarë në dy fraksione, opozita e vetme tani janë “qytetarët në rrugë”, tha ai. Duke iu referuar politikaneve kryesorë që kanë dominuar politikën që nga rënia e komunizmit në fillim të viteve 1990, ai tha se vetëm tre figura politike kanë udhëhequr vendin për 30 vjet dhe se të gjithë ata ishin “vampirë”. “Ky është një moment historik për Shqipërinë. Asnjë vend që dëshiron të hyjë në Evropë nuk është pa opozitë siç jemi ne. Sot opozita e vetme në Shqipëri janë qytetarët që mbushin sheshet këto ditë”, tha ai për BIRN.

Sipas Binajt, Shqipërisë i duhet “gjak i ri, i pastër, patriotik, që nuk është pjellë e politikës që ka grabitur vendin për interesat e veta”. “Sot kemi një shoqëri anemike dhe të asfiksuar, një rini të shtypur dhe të nënshtruar dhe një elitë të blerë dhe të emigruar”, tha ai. Ata që ndajnë “ëndrrën për ta parë Shqipërinë ashtu siç e meriton, janë me mua”, tha Binaj – “dhe me protestuesit në shesh dhe me qindra mijëra njerëz me të cilët komunikoj në rrjetet sociale dhe takohem çdo ditë”.

“Tani është radha e tyre!” nënvizoi Binaj.



Florjan Binaj gjatë protestave në Tiranë. Foto: Nensi Bogdani / BIRN

e re. Vitet e fundit është shtuar edhe gjuajtja me korrent përmes gjeneratorëve. Di-hen edhe personat që gjuajnë me dinamit e korrent, por nuk i kap askush,” tha Dina.

Sipas peshkatarit, shteti nuk ndjehet fare as për t’i këshilluar ata që përdorin mjete të paligjshme për dëmin që po sjellin. “Kemi ngritur zërin disa herë, por nuk ka asnjë reagim nga shteti,” shtoi ai.

Dina shpjegon se për të ndaluar peshkimin me eksplozivë nuk është e nevojshme të lësh roje në liqen, por mjafton të kontrollosh tregun.

“Njihet krapi që gjuhet me dinamit, pasi ka brinjët e thyera dhe ngjyrë tjetër nga ai që peshkohet me rrjetë,” tha ai. “Nuk duan, se gjuetia e paligjshme me pak punë frenohet,” shtoi peshkatarin.

Drejtimesit e Inspektoratit të Peshkimit në Kukës, i cili prej një viti është bashkuar edhe me Dibrën, pretendojnë se e kanë monitoruar liqenin.

Inspektori Ervin Ruçi i tha “BIRN” se ata kishin denoncuar dy persona të kapur duke bërë peshkim të paligjshëm.

“Bashkë me Task-Forcën kemi inspektuar Liqenin e Fierzës, ku kemi denoncuar dy persona problematikë që gjuajnë në mënyrë të jashtëligjshme,” tha Ruçi.

Megjithatë, denoncimet e pretenduara nga Ruçi nuk duket se kanë shkuar shumë larg, pasi prokuroria e Kukësit i tha BIRN se nuk kishte çështje të tilla në hetim.

“Në prokurorinë e Kukësit nga policia kemi vetëm një denoncim për gjueti të paligjshme, por ai ka të bëjë me gjuetinë e kafshëve të egra, jo peshkut,” tha Hilmi Duraku, kryesekretar në Prokurorinë e Kukësit.

Peshkimi në liqenin e Fierzës është vështirësuar edhe për Emri Llukovin, një 70 vjeçar që gjuan me grep për të shtyrë kohën e lirë.

“Dalim çdo ditë herët,” tha ai, ndërsa shtoi se të shumtën e rasteve “nuk bie asnjë peshk në grep”.

Në mënyrë të përsëritur dëgjohej togfjalëshi: “Shqipërisë i duhet një opozitë e fortë”. Ky tingëllon shumë si një lloj justifikimi që sugjeron se fajin për keqqeverisjen e ka “mungesa e opozitës”. Kam përshtypjen se e kundërta është më e vlefshme.

Opozita (dhe qeveria) që i duhet Shqipërisë

GJERGJ EREBARA | BIRN | TIRANË

Shqipëria ka nevojë për qytetarë, për media, për prokurorë, gjyqtarë, për botë akademike. Ka nevojë për pronarë që të gëzojnë pronat dhe bizneset e veta, ka nevojë për ndihmë ekonomike që jepet mbi bazat e nevojës shoqërore dhe nuk shpërdorohet si kartëmonedhë për të blerë vota. Shqipëria ka nevojë për shpresë.

Ka nevojë mbi të gjitha për një set vlerash të njohura si “shteti i së drejtës” apo “sundimi i ligjit”. Ka nevojë për të drejta punëtorësh, në mënyrë që një mësues apo një mjek të mos ketë frikë se do të pushohet nga puna nga drejtori politik dhe, duke pasur sigurinë e domosdoshme në punë, është në gjendje të shërbejë jo vetëm si mësues apo si mjek, por edhe si qytetar.

Të gjitha këto nevoja apo domosdoshmëri dëgjohej rrallëherë, ndërsa një nevojë dëgjohej më fort se sa të tjerat: konkretisht, nevoja “për të pasur një opozitë të fortë”.

E dëgjon këtë togfjalësh nga ndërkombëtarë të ndryshëm, e dëgjon madje madje, edhe nga vetë politikanët e maxhorancës, të cilët, jo rrallëherë, ta japin si justifikim për keqqeverisjen.

Qeverisja është keq, sugjeroi vetë Edi Rama pas protestave studentore të vitit 2019, sepse nuk ka “presion pozitiv” nga opozita.

Duke qenë se opozita partiake është vetëm një nga faktorët që e bën një shoqëri demokratike, ky lloj argumenti mund të shtrihet më tutje: qeverisja është keq sepse nuk ka “presion pozitiv” nga prokurorët që duhet të luftojnë korrupsionin; është keq për shkak se nuk ka akademikë me ekspertizë në fushat e veta dhe me kurajë qytetare për të diskutuar publikisht politikën e gabuara apo dritëshkurtra dhe për të propozuar politika alternative, të mira dhe largpamëse; është keq sepse nuk ka qytetarë të lirë, nuk ka punëtorë me siguri të padiskutueshme në punë, sepse në Shqipëri, është fakt që dora e gjatë dhe dhunuese e partisë në pushtet hyn te kompanitë që janë formalisht pronë private për të detyruar punëtorët të votojnë në këtë apo atë mënyrë; është keq për shkak se media në shumicë varet nga pushteti politik për të dhënë paga; është keq se nuk ka mjaftueshëm kurajë politike nga qytetarët, se njerëzit janë të varfër dhe se, në një farë mënyre, demokracia është produkt shoqëruar i mirëqenies; është keq për shkak se të dhënat personale të qytetarëve vidhen haptazi dhe përdoren për të dhunuar qytetarët, ndërsa prokurorët duket se



Lulzim Basha duke dalë nga selia e Partisë Demokratike pasi dha dorëheqjen më 21 mars 2022. Foto: LSA

janë bashkëpunëtorë në krim; është keq për shkak se korrupsioni nuk luftohet dhe krimi i organizuar nuk luftohet deri në atë pikë sa mundet edhe të kapadaset në formën e betonit nëpër qendrat e qyteteve shqiptare, shoqëruar këto me mori kamerash private që kanë krijuar një Big Brother, ku ka shumë “vëllezër të mëdhenj”, ca në politikë dhe ca në krim.

Vetëm se të gjitha këto duket se e kanë kapur shkakun dhe pasojën në drejtësinë e gabuar. Nuk është faj i qytetarëve për mungesën e të drejtave në punë, as për mungesën e të drejtave të pronësisë. Nuk është faj i qytetarëve për mungesën e prokurorëve të pavarur dhe të aftë. Nuk është faj i opozitës për mungesën e shtetit ligjor. Nuk është faj i

